



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**“Financë-Kontabilitet”**

**Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Rezarta SHKURTI PERRI**

**Dr. Erinda IMERAJ**

**Dhjetor / 2023**

## **TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **Bachelor në: “Financë Kontabilitet”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Financë Kontabilitet”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 685, dt. 25.08.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendimi Senati Nr. 21. datë.30.03.2021
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 264, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i pare
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE / 12 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 107 studentë; 2021-2022 113 studentë; 2022-2023 115 studentë.
19	Komente / të tjera:	-



## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është hapur në vitin 2010 me VKM nr. 685, datë. 25.08.2010. Programi i studimit u përshtat me vendim të Senatit Akademik të UAMD nr. 99 datë 14.06.2018 dhe në vitin 2021 u bë edhe riorganizimi i programit me ndryshime të vogla nën 20% sipas vendimit nr. 21 të Senatit Akademik të UAMD, datë. 30.03.2021. Institucioni i Arsimit të Lartë, publik, "Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) është themeluar në vitin 2005 në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 801. Studimet në këtë Institucion u ofruan për herë të parë në vitin akademik 2006-2007. UAMD është riorganizuar sipas VKM Nr. 685, dt 25.08.2010 në 5 fakultete të cilat janë edhe njësitë kryesore aktuale të Institucionit konkretisht:

- 1. Fakulteti i Biznesit;**
2. Fakulteti i Edukimit;
3. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
4. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;
5. Fakulteti i Studimeve Profesional;

UAMD ka marrë akreditimin institucional të parë në bazë të Vendimit Nr. 10, datë 07.04.2017, të Bordit të Akreditimit të ASCAL dhe është riakredituar me Vendimin nr. 18, datë 24.03.2022 nga Bordi i Akreditimit të ASCAL, duke përmbushur kështu kërkesat ligjore për themelimin dhe akreditimin institucional. Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ofrohet nga Fakulteti i Biznesit, si njësi kryesore. Ky Fakultet është hapur me VKM Nr. 801, dt 20.12.2006. (Kur u krijua ai njihej si Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, ndërsa që nga viti 2010 emërtohet si "Fakulteti i Biznesit" (FB) në përputhje me riorganizimin e institucionit).

Fakulteti i Biznesit (FB), në UAMD përbëhet nga 6 njësi bazë:

- 1. Departamenti i Financë-Kontabilitet;**
2. Departamenti i Menaxhimit;
3. Departamenti i Marketingut;
4. Departamenti i Shkencave Ekonomike;
5. Departamenti i Turizmit;
6. Departamenti i Statistikës dhe i Informatikës së zbatuar;

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, pranë FB është njësi bazë përgjegjëse që ofron programin e studimit Bachelor në "Financë Kontabilitet". Ky program studimi është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, si pjesë e fushës së financës dhe kontabilitetit. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky program është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale tre vite akademike (gjashtë semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Financë Kontabilitet". Objektivi kryesor i këtij programi është edukimi dhe kualifikimi shkencor i studentëve në fushën e financës dhe të kontabilitetit, përmes integritit të mësimin të njohurive themelore në këto fusha me praktikën dhe njohuritë



aplikative. Gjithashtu, ky program studimi synon të sigurojë një nivel njohurish në fushën e financës dhe kontabilitetit të krahasueshëm me programet e studimit të nivelit të parë të institucioneve analoge ndërkombëtare.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Në datën 21.01.2022, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Financë – Kontabilitet". ASCAL bazuar në *“Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”* ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Dr. Rezarta Shkurti Perri** pedagoge në FEUT, Departamenti i Kontabilitetit dhe **Dr. Erinda Imeraj**, Pedagoge në Universitetin Epoka. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, **Msc. Majlinda Demirneli**.

Në afatin kohor 24.04.2023 - 15.05.2023 ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 4 dhe 5 Korrik 2023 në ambientet e UAMD. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët pas vizitës në Institucion u vu në dispozicion në sistemin e informacionit të ASCAL datën 14.07.2023.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 08.11.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 15/174 Prot, datë 08.11.2023. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës më datë 24.11.2023, njofton, me anë të shkresës me Nr.2139 Prot, datë 22.11.2023 *“Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”*.

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

1. Për komentin e IAL mbi **standardin II.1 tek rubrika “Konkluzione”**, konkluzioni i GVJ për këtë pikë lidhet me gjykimin më të mirë të GVJ dhënë sfondin e ekspertizës së tyre

dhe besimin që ata kanë se ky ndryshim do të rriste akoma më shumë vlerën dhe përfitimet e studentëve nga përmbajtja e programit të studimit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

2. Për komentin e IAL mbi *standardin II 4, kriteri 7*, GVJ ka dhënë sugjerimin e tij ndërsa IAL ka marrë vendimin përkatës duke dhënë edhe arsyetimin përkatës për këtë vendim. GVJ megjithatë, gjykon se opinioni i shprehur në Draft Raport është më i përshtatshëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. Për komentin e IAL mbi *standardin II.4, tek rubrika “Konkluzione”*, GVJ vazhdon të gjykojë që në aftësimin më të mirë të studentëve të nivelit Bachelor do të ishte më mirë një Plan mësimor me më pak lëndë ku secila prej tyre të kishte më shumë kredite dhe punë në klasë dhe individuale. GVJ e kupton që IAL e argumenton këtë vendim bazuar në reflektimet nga ana e partnerëve të saj, megjithatë vazhdon të jetë e mendimit të shprehur në Draft Raport. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
4. Për komentin e IAL mbi *standardin III.4, tek rubrika “Konkluzione”*, GVJ vazhdon të mendojë që programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet i ofruar në UAMD është i organizuar *kryesisht mirë*, por jo *plotësisht mirë*, ndaj edhe standardi III.4 përmbushet kryesisht dhe jo plotësisht. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
5. Për komentin e IAL mbi *standardin VI.3, kriteri 3*, GVJ ka dhënë sugjerimin e tij mbi krijimin e një procedure të re me fokus vlerësimet paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, procedurë kjo që merr parasysh formatin, ngarkesën, minutazhin, përmbajtjen, nivelin dhe metodën e vlerësimit të provimeve të studentëve. GVJ dakordëson me argumentin e IAL që procesi i vlerësimit të studentëve është pjesë e cdo rregulloreje por sugjerimi është për një proces i cili fokusohet në monitorimin e cilësisë së saj, kështu GVJ vazhdon të jetë e mendimit të shprehur në Draft Raport. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
6. Për komentin e IAL mbi *standardin VI.3, kriteri 4*, GVJ ka sugjeruar formalizim dhe raporte konkrete nga intervitat me bashkëpunëtorë të jashtëm apo pyetësorë më të detajuar me të diplomuarit e IAL në kuadër të përmirësimit të programit të studimit referuar kërkesave të tregut. Detajimi i pyetësorëve mbi aftësitë e përfuara nga programi dhe kërkesat e punëdhënësve të të diplomuarve sjell vlerësime dhe rekomandime konkrete për programin. Gjithashtu, kjo do ndihmonte dhe në freskimin e studimeve periodike të tregut. GVJ vlerëson marrëdhënien e afërt të IAL me studentët pavarësisht numrit të ulët në pjesëmarrjen e tyre në pyetësore, megjithatë vazhdon të jetë e mendimit të shprehur në Draft Raport. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë - Kontabilitet”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, (në vijim, GVJ) shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni dhe që është pjesë e Dosjes së Vetë Vlerësimit (në vijim DVV), si Statutin e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës (në vijim UAMD), Rregulloren e Universitetit dhe Planin Strategjik të Fakultetit të Biznesit duke konstatuar disa elemente që duket se garantojnë ofrimin e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në mbështetje të avancimit të interesave kombëtare. Kështu, vizioni i UAMD sic referohet në pikën 1 të Planit të Zhvillimit Strategjik është që:</p> <p>Universiteti të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore, si një realitet i ri dhe dinamik duke ofruar një alternativë serioze në panoramën e Arsimit të Lartë. Universiteti synon të jetë faktor vendimtar në “ekonominë e dijes”, nëpërmjet formimit të profesionistëve të rinj, të gatshëm të përballen me sfidat e tregut të punës dhe në të njëjtën kohë të shfrytëzojnë mundësitë që bota dhe tregjet ndërkombëtare ofrojnë. Në Statut (neni 3) deklarohet se UAMD ka si mision të shumëfishtë, ndër të tjera edhe: (a) krijimin, zhvillimin dhe përcjelljen e dijes përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe nxitjen e arteve, edukimit fizik dhe sporteve; (b) formimin e specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj; (c) zhvillimin e të menduarit kritik dhe analitik e kultivimin e ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj kulturave dhe ngjarjeve që kanë rëndësi për komunitetin; (d) nxitjen e aftësive për sipërmarrje. UAMD ofron programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në fushën e shkencave ekonomike që, në këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm është një prioritet i përhershëm i zhvillimit kombëtar. Sikurse formulohet në misionin e deklaruar të Institucionit në Statutin e tij, misioni i UAMD është avancimi i zhvillimit të vendit duke përgatitur shkencëtarë të rinj në shërbim të komunitetit dhe kulturës cka</p>





	<p>konsiderohet nga ekspertët si konform vlerave dhe traditave kombëtare dhe përmbush këtë kriter.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Financë – Kontabilitet në UAMD është i hartuar në përputhje me misionin e Institucionit sic deklarohen në Statutin (neni 3) dhe qëllimet e tij (Statuti, neni 4). Gjithashtu, dokumenta të tjerë strategjikë të shqyrtuar nga GVJ si Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit (vitet 2016 – 2020), Plani Strategjik i Zhvillimit të Institucionit (vitet 2021-2025) dhe Plani Strategjik i Departamentit të Financë Kontabilitetit (2021 – 2025) mbështesin faktin se fusha e veprimtarisë së programit të studimit përputhet me atë të Institucionit. Në Planin Strategjik të UAMD (2021 – 2025) GVJ konstatoi se Institucioni karakterizohet nga diversiteti dhe larmia e programeve të studimit që ofrohen në disiplina të ndryshme, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekonomi/shkenca ekonomike (biznes/sipërmarrje, financë-kontabilitet, turizëm.</li> <li>• Shkenca sociale e humane (Edukim/Pedagogji, Sociologji/Probleme Sociale,</li> <li>• Shkenca politike e juridike (Drejtësi, Administrimi Publik/Administratë.</li> <li>• Teknologji dhe Informacion (Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni); Shkenca Mjekësore (Mjeksi/ShëndetPublik); Shkenca të natyrës dhe inxhinierike (Shkenca Inxhinierike, Mekanikë, Transport).</li> </ul> <p>Misioni i Universiteti “Aleksandër Moisiu”, është të sjellë shkencë dhe punësim, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, të studiuarit gjatë gjithë jetës, aftësimit të personelit akademik (Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2021 – 2025), pika 2).</p> <p>UAMD, ka si mision të kryejë mandatin e tij arsimor dhe shkencor në mënyrë të kënaqshme dhe në hap me kohën, të promovojë Arsimin e Lartë dhe mbështesë projekte inovative kërkimore që inkurajojnë dhe forcojnë lidhjen midis tregut të punës dhe Universitetit, të garantojë mundësi të barabarta për stafin akademik në përfitimet e financimeve për kërkim</p>



	<p>shkencor. Formimi, zhvillimi dhe transmetimi i dijeve citohen si objektiva kryesorë të institucionit me qëllim aftësimin e studentëve dhe suksesin profesional të tyre. Për sa më lart, GVJ konfirmon se programi i studimit përputhet me fushën e veprimtarisë së UAMD sic dëshmojnë dokumentat strategjike institucionale.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025 .pdf</i></p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu , Durrës.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se përmbajtja e DVV në lidhje me këtë kriter është tërësisht e plotë. UAMD ka hartuar Statutin, Rregulloren e Institucionit dhe Rregulloren e Fakultetit të Biznesit e cila është njësi kryesore që ofron programin e studimit, si edhe Plan të zhvillimit strategjik në nivel institucioni, njësi kryesore dhe njësi bazë, madje edhe një dokument i cili zberthen strategjinë në masa dhe tregues të synuar për t'u arritur në vitet e afërme (dokumenti "Planifikimi i veprimtarive strategjike 2021 – 2023" në DVV).</p> <p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre dokumentave, konstatohet se Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ofrohet në përputhje me synimin e Fakultetit të Biznesit, për të ofruar programe studimi në fushën akademike: ekonomi / shkencë ekonomike, si biznes e sipërmarrje, financë – kontabilitet, turizëm, menaxhim dhe marketing. Programet e studimit të ofruara synohet të jenë bashkëkohore, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit, pasi përcaktimi i fushave prioritare të studimit është identifikuar në interes të zhvillimit rajonal e kombëtar. Për sa i përket interesit rajonal, UAMD synon trajnimin e specialistëve në sektorët e turizmit, detarisë, menaxhimit dhe shërbimeve financiare. Pika 4 e Planit të Zhvillimit Strategjik Institucional shprehet se investimi në cilësinë e mësimdhënies, është një përparësi e Universitetit, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparura kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu objektiv i rëndësishëm konstatohet se është edhe favorizimi i metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës</p>





	<p>dhe promovimin e dialogut student-pedagog. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025 .pdf</i></p> <p><i>Planifikimi i Veprimtarive Strategjike 2021-2023 të Universitetit "Aleksandër Moisu", Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se UAMD disponon kapacitetet e nevojshme në fushën akademike përsa i përket burimeve njerëzore si edhe burimet e duhura infrastrukturore për të ofruar studime të nivelit të parë në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. UAMD është themeluar në vitin 2005 dhe ka mbi 15 vite përvojë në mësimdhënie në fushën e financave (financë, bankë, kontabilitet), shpesh edhe në partneritet me partnerë akademikë dhe jo akademikë vendas dhe të huaj. Institucioni gëzon emër të mirë dhe ka përvoja të mëparshme të sukseshme në programe studimi cilësore në fushën ekonomike, të cilat ofrojnë një suport të mirë për ofrimin e programit aktual të studimit. GVJ shprehet për përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe</p>	<p>Sipas organogramës së Institucionit, dhe në përputhje me dokumentacionin konstatohet se njësi kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, Bachelor në Financë Kontabilitet është Fakulteti i Biznesit, kurse njësi bazë është Departamenti i Financë Kontabilitetit. GVJ konfirmon se fusha e përgjithshme e programit të studimit (ekonomia dhe biznesi) dhe fusha specifike (financa dhe kontabiliteti) kanë përputhje të plotë me fushat akademike dhe kërkimore përkatësisht të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë. Programi i studimit i përket Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe, sipas dokumentacionit në DVV, është riorganizuar (në nivelin më pak se 20%) në vitin 2021. GVJ hasi gjithashtu evidencë edhe për kërkesën në lidhje me kodifikimet e programeve të</p>

<p>udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>studimit të ofruara nga Departamenti i Financë Kontabilitetit në përputhje me VKM nr 310/2022 dhe Udhëzimin nr 31/2022 të MASR në lidhje me kodifikimin. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga drejtuesit e njësive kryesore dhe njësive bazë ky process është në zhvillim e sipër.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Organigrama e Universitetit Aleksandër Moisu.pdf</i></p> <p><i>Vendim i Senatit Akademik nr. 21 dt 30.03.2021 për Riorganizimin nën 20_ të programit të studimit Bachelor Financë Kontabilitet .pdf</i></p> <p><i>Kërkesë për propozime të kodifikimit të programeve të studimit.pdf</i></p> <p><i>Shkresë për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Financë Kontabilitetit.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ofrohet në përputhje me vlerat dhe prioritetet e zhvillimit të vendit tonë. Njësia kryesore që ofron programin e studimit (Fakulteti i Biznesit në UAMD) dhe njësia bazë (Departamenti i Financë Kontabilitetit) janë në përputhje të plotë me fushën, prioritetet dhe sferën akademike dhe kërkimore të programit të studimit.</p> <p>UAMD ka përpiluar një set të plotë të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm si Statuti i Institucionit, Rregullore në nivel njësie kryesore, bazë dhe program studimi si edhe Plan të zhvillimit strategjik në nivel Institucional, njësie kryesore dhe bazë, të zberthyer në indikatorë të synuar për t'u përmbushur në cdo dy vite. Dhënë tërësinë e këtyre gjetjeve, GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij standardi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen</p>	<p>Nga analiza e Statutit të Institucionit (Kreu II) si edhe e Rregullores së UAMD (Kreu II), GVJ konstaton se Institucioni</p>



<p>dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>ka përshkruar në këto dy dokumenta shumë të rëndësishëm elemente kyce si organizimin, strukturën, detyrat, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e secilës njësi përbërëse të tij, si njësia kryesore dhe ajo bazë, Senati, Bordi i Administrimit, Rektori dhe Dekanati. Secila prej këtyre njësive përbërëse të funksionimit të Institucionit ka liri akademike dhe organizative (neni 5 i Statutit) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore – shkencore e të inovacionit si dhe veprimtaritë krijuese në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Cdo njësi përbërëse si fakulteti dhe departamenti (nenet 9 &amp; 10 në Statut) kanë detyra respektive të përshkruara në mënyrë të qartë dhe të detajuara. Njësitë drejtuese monitorojnë vazhdimisht aktivitetin dhe analizojnë rezultatet e veprimtarisë (nenet 13 &amp; 14 të Statutit). Në rregulloren institucionale përshkruhen edhe më me detaje organizimi, përbërja, mbledhja, funksionimi dhe përgjegjësitë e komisioneve të përhershme në nivel institucional dhe njësie kryesore. Rregullorja e njësisë bazë gjithashtu ofron mbështetje për ndarjen e detyrave të personelit brenda kësaj njësie. GVJ konfirmon edhe se njësia bazë angazhohet rregullisht në analizën vjetore të punës që kryhet nga një grup i posacëm i ngritur nga përgjegjësi i departamentit FB, në përputhje me pikën 4, neni 27 të Rregullores institucionale, i cili përshkruan detyrat e drejtuesit të njësisë bazë.</p> <p>GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vendim ngritja e grupit te punes per analizen e departamentit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se sipas pikës 4 në Planin e Zhvillimit Strategjik Institucional, në UAMD është në fokus përdorimi me efektivitet i marrëveshjeve ekzistuese mbi praktikat e studentëve dhe arritja e marrëveshjeve të reja që synojnë krijimin e lidhjeve reale me tregun e punës me qëllim punësimin e mundshëm të tyre si edhe krijimi i një mekanizmi ndërlidhës efektiv të Zyrës së Karrierës dhe Alumni me departamentet e ndryshme të universitetit. Gjithashtu sipas Planit Strategjik të Departamentit FB, Prioriteti 3 është: Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit,</p>




	<p>komunikimit dhe qasja ndërdisiplinore ku disa nga synimet e këtij prioriteti janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunim të ndërsjellë me institucionet bankare dhe biznese të ndryshme në shërbim të ndërtimit të lidhjeve mes universitetit dhe biznesit;</li> <li>• Bashkëpunim të ndërsjellë me kompanitë e sigurimit dhe fondet e investimit;</li> <li>• Marrëveshje bashkëpunimi me departamente homologe brenda dhe jashtë vendit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;</li> <li>• Marrëveshje bashkëpunimi me institucione financiare, organizma të ndryshëm në fushën akademike si dhe të biznesit në kuadër të mundësimit të praktikave dhe punësimit të studentëve;</li> <li>• Përfshirjen e stafit akademik në shkëmbime eksperience përmes mobiliteteve të ndryshme Erasmus + të cilat ndihmojnë në trajnimin e tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe në sjelljen e risive në aspektin e metodave interaktive të përdorura prej lektorëve;</li> </ul> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe sipas konfirmimeve të kryera pas vizitës në Institucion, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe si edhe me partnerë brenda dhe jashtë vendit, ku ndër më të rëndësishmit dhe strategjikët përmenden Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë, etj. Një listë e marrëveshjeve në kuadrin institucional është pjesë e DVV.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025 .pdf</i></p> <p><i>Lista e marrëveshjeve në kuadër Institucional të UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</p>	<p>Nga lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel njësie kryesore, GVJ konstaton shumë institucione me të cilat mundësohet bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale dhe mësimore, si Drejtoria Rajonale Tatimore, Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë, AKH Consulting, IPPM, etj. Përmbajtja e këtyre marrëveshjeve është dorëzuar e plotë në DVV dhe mesa GVJ konstaton, aty parashikohet bashkëpunimi për të mundësuar punën në praktikë të studentëve të UAMD, përfshi edhe studentët e programit të studimit. Stafit akademik konfirmoi gjatë vizitës në Institucion bashkëpunimin e ngushtë</p>





<p>praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>me aktorët e tregut në favor të rritjes së cilësisë së aktivitetit mësimor për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në DVV janë përfshirë të paktën dy dokumenta të plotë ku konstatohet analiza e kujdeshme që UAMD ka bërë në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit: 1 – Raporti i Drejtorisë së Projekteve mbi ecurinë e bashkëpunimeve, që analizon kryesisht marrëveshjet dhe projektet me universitete të huaja, dhe 2 – analiza e marrëveshjeve të departamentit të FK, ku fokusi është analiza e marrëveshjeve me me institucione shtetërore, kompani private, banka të nivelit të dytë dhe institucione shtetërore: Drejtoria e Tatimeve Durrës, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, banka të ndryshme, kompani sigurimi, biznese, zyra kontabiliteti, etj.; dhe Institucione tjera të Arsimit të Lartë.</p> <p>GVJ konstaton se aktivitetet kryesore të UAMD dhe njërive kryesore dhe bazë në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të tjerë kanë qenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aktivitetet e përvitshme me përfaqësues të Drejtorisë së Tatimeve, Durrës; përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të tjerë;</li> <li>- Praktikant mësimor pranë bizneseve private, bankave, kompanive të sigurimit dhe institucione të tjera, pavarësisht se praktikant mësimor për programin e studimit Bachelor në Financë kontabilitet janë përfshirë në kurrikul të fundmi;</li> <li>- Angazhimin në mësimdhënie të specialistëve më të mirë në këto institucione, për lëndë të cilat ndikojnë në formimin dhe njohuritë e studentëve. GVJ konstatoi edhe gjatë vizitës në Institucion, leksionet e hapura me lektorë të ftuar nga bota e biznesit dhe specialistëve përkatës;</li> <li>- Bashkëpunimeve në botime dhe konferenca, duke gërshetuar literaturën bashkëkohore me shifrat, rastet e studimit dhe vëzhgimet, si të dhëna të kërkimit primar;</li> </ul> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Raport mbi ecurinë e bashkëpunimeve_Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhëniet me jashtë.pdf</i></p> <p><i>Analize e Marrëveshjeve Dep. FK, V.A 2021-2022.pdf</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD ka hartuar një set të plotë të bazës nënligjore përkatëse ku parashikohen detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e bashkëpunimit e strukturave përbërëse të Institucionit. UAMD ka shumë marrëveshje bashkëpunimi në funksion të garantimit</i></p>



	<i>të një procesi mësimor të kompletuar me aktivitete në ndihmë të arritjes së objektivave të programit si praktika, konferenca, leksione të hapura etj. UAMD analizon marrëveshjet e bashkëpunimit duke reflektuar përmirësimet e arritura dhe duke sugjeruar zgjerimin e këtyre marrëveshjeve në të ardhmen. Mbështetur në këto gjetje, GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Në lidhje me kërkesat e këtij kriteri, GVJ shqyrtoi Rregulloren e programit të studimit ku në nenin 14 përshkruhen komponentët mësimorë të programit të studimit si Plani Mësimor dhe Syllabuset në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në vendin tonë. Mbështetur në tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar, si Plani Mësimor, Rregullorja e Programit të studimit, dhe Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet i ofruar në UAMD, është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është me kohë të plotë dhe mësimdhënia është në gjuhën shqipe me një kohëzgjatje 3 vjet dhe 6 semestra në përfundim të të cilit përftohen 180 kredite, të paktën 60 kredite në vit dhe lëshohet diplomë universitare “Bachelor”. Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në



	<p>UAMD është i vlerësuar edhe sipas sistemit amerikan të krediteve UsCr (Rregullorja e programit, neni 14, pika 1).</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se që nga viti akademik 2022-2023, ishte marrë vendimi që programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet të jetë ndër programet e studimit të cilat do të ofrohen edhe në gjuhën angleze për studentët. Evidenca mbështetëse për këtë vendim u sigurua nga Institucioni nëpërmjet dokumentacionit shtesë. Studentët e programit konfirmuan realizimin e procesit mësimor në lëndë të caktuara në gjuhën angleze.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Plani Mësimor, Tabelat RVB</i></p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të brendshëm</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>Dokumentacion shtesë: Programet e studimit ne gjuhen angleze.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ konfirmon se në Rregulloren e UAMD (neni 43, pika 1) specifikohet pikërisht çfarë kërkon ky kriter, pra që se programet e studimit të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi të caktuara në një larmi të gjerë profesionale e specialitetesh. Në vijim, në Rregulloren e programit të studimit, neni 2, afirmohen misioni dhe objektivat e programit të cilat në gjykimin e GVJ, synojnë përgatitjen e studentëve të aftë dhe formimin e specialistëve të fushës së financës dhe kontabilitetit. Në Planin Mësimor të programit të studimit vihet re se tërësia e lëndëve dhe moduleve të detyrueshme dhe atyre me zgjedhje të përfshira në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ofron një mbulim të mirë të disiplinave specifike në fushat e Kontabilitetit dhe të Financës si edhe në disiplina të tjera të ndërlydhura me to si ekonomia, menaxhimi, marketingu, matematikë, statistikë, fiskalitet, financa personale etj. Si program studimi që i përket Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), ai synon të përcojë njohuritë themelore për metodat dhe parimet, si dhe aftësitë specifike në një larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh ku përfshihen edhe Kontabiliteti dhe Financa. Përmbajtja e syllabuseve dhe programeve lëndore, të shqyrtuara gjithashtu nga GVJ tregon se studentët mund të aftësohen për t'u përgatitur profesionalisht si edhe nga ana akademike dhe të pajisen me njohuri të aplikuara për zgjidhjen e problematikave të ndërthurura në drejtimin ekonomik të</p>



	<p>njësive publike dhe private. GVJ konstaton edhe që shumica e lëndëve të ofruara në të gjitha kategoritë kanë 4 ose 5 kredite dhe kanë të parashikuar deri në 45 orë në auditor, orë të cilat nuk kanë një organizim të përcaktuar në leksione dhe seminare, por janë lënë në zgjedhjen dhe lirinë e stafit akademik për ta organizuar, në përputhje me statutin (neni 72, pika 4.c) dhe rregulloren e institucionit (neni 60, pika 5.c).</p> <p>Në opinionin e GVJ 45 orë në auditor (pra 4 ose 5 kredite) mund të jenë të pamjaftueshme për lëndët e tipologjisë B. Gjatë vizitës në auditor gjithashtu u diskutua fakti që për shkak se lëndët e këtij programi studimi kanë të gjitha 4 – 5 kredite, kjo shton numrin e lëndëve për çdo vit akademik dhe edhe ngarkesën për studentët.</p> <p><i>GVJ sugjeron që departamenti të rishikojë përmbajtjen e programit, sigurisht brenda kufijve të ndryshimeve të lejuara sipas legjislacionit në fuqi, si rritja e numrit të krediteve deri në 6 kredite për lëndët e tipologjisë B, dhe kalimi i disa prej lëndëve të tipologjisë C në lëndë me zgjedhje, (përvec atyre tashmë të parashikuara si lëndë më zgjedhje në Planin Mësimor të Programit, por që në fakt deri më tani nuk janë ofruar si lëndë me zgjedhje, sikurse edhe u konfirmua me studentët e programit gjatë vizitës në Institucion).</i></p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Plani Mësimor</i></p> <p><i>Statuti i UAMD</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>RREGULLORE E PROGRAMIT TE STUDIMEVE CIKLI I PARE 'BACHELOR' PR.pdf</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i></p> <p><i>Syllabuset e lendeve te ofruara ne vite</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të Studimit (<i>tabela 9 në RVB</i>), GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41 të ndryshuar. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen me kredite. Lëndët me zgjedhje janë konkretisht të kategorisë C, të vlerësuara me 4 ECTS. Lëndët e kategorisë A janë të gjitha me 4 ECTS, ndërsa lëndët e kategorisë B janë kryesisht me 5 ECTS, me disa përjashtime të vogla për disa lëndë të cilat janë me 4 ECTS.</p>



	<p>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, për programin e studimit Bachelor në nivelin 6 të KSHK kategorizimi i lëndëve është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme dhe kjo duhet të përfaqësojë 15% - 20% të krediteve;</li> <li>- Në kategorinë B, që janë lëndët bazë, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe kjo duhet të përfaqësojë 50% - 55% të krediteve;</li> <li>- Në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje dhe kjo duhet të përfaqësojë 12% - 15% të krediteve;</li> <li>- Në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale dhe kjo duhet të përfaqësojë 10% - 15% të krediteve;</li> <li>- Në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse që përfaqësojnë 3% - 5% të krediteve;</li> </ul> <p>Gjithashtu, për programet e studimit Bachelor përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70%, kriter ky që përmbushet nga ky program studimi, ku kategoritë A dhe B së bashku përfaqësojnë 73.33% të krediteve.)</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Plani Mësimor</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në Planin Mësimor të Programit të Studimit mund të konfirmohet se është parashikuar kryerja e Praktikës profesionale në semestrin e gjashtë të studimeve. Praktika profesionale është vlerësuar me 6 ECTS dhe i përket lëndëve të kategorisë D. Po kështu, detyrimet përmbyllëse për këtë program parashikohen në formën e temës së diplomës ose provimit përfundimtar (kjo në varësi të notës mesatare të studimeve) dhe sipas Planit Mësimor janë të vlerësuara me 6 kredite. Pra ky kriter është i përmbushur.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Plani Mësimor</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i></p> <p><i>Rregullorja e programit të studimit.</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së UAMD, nenet 43 &amp; 44, GVJ mund të konstatojë se organizimi i studimeve në programet e ciklit të parë të ofruara nga ky Institucion janë organizuar me 180 kredite me kohëzgjatje normale jo më pak se tre vite akademike, duke përbushur kështu kërkesat ligjore në fuqi. Pranimi në programet e ciklit të parë të studimeve dhe planifikimi i kuotave gjithashtu bëhen konform kërkesave ligjore. Sipas rregullores, çdo departament duhet të përcaktojë kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 10 dhjetor e vitit akademik paraardhës. Kuotat dhe kriteret e përcaktuara bëhen publike nga departamentet jo më vonë se data 20 dhjetor e vitit akademik paraardhës dhe si rregull këto kritere nuk duhet të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimit. Kriteret i përcillen Rektoratit të UAMD dhe pas miratimit nga Senati i dërgohen ministrisë përgjegjëse. Sipas pikës 6, neni 44 i Rregullores kanë të drejtë të kandidojnë për pranim në studimet e ciklit të parë të UAMD: a) kandidatët që kanë përfunduar me sukses Maturën Shtetërore dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM; b) kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj; c) shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe. Sic u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, këto modalitete të parashikuara në rregullore zbatoheshin me efektivitet nga Institucioni dhe mbështeteshin me dokumentacionin e plotë të nevojshëm.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Memo “Kuotat e pranimit të studentëve për të tre nivelet e studimit për Departamentit Fina.pdf</i></p> <p><i>Publikimi i kritereve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentit: “Analizë krahasuese e programeve të studimit të ofruara nga universitetet publike brenda vendit” që ishte pjesë e DVV, u konstatua se vetë Institucioni ishte angazhuar në një proces krahasues të përmbajtjes dhe brendisë së kurrikulës së programeve të studimit të ciklit të parë, të fushës së studimit “Financë Kontabilitet” të ofruara nga universitete publike brenda vendit. Për krahasim ishin marrë përkatësisht kurrikulat e programeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bachelor Financë – Kontabilitet – Universiteti Bujqësor i Tiranës;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bachelor Financë – Kontabilitet – Universiteti i Tiranës;</li> <li>- Bachelor Financë – Kontabilitet – Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi;</li> <li>- Bachelor Financë – Kontabilitet – Universiteti i Elbasanit “Aleksander Xhuvani;</li> </ul> <p>Nga analiza e kryer në lidhje me këto programe studimi, UAMD thekson në dokumentin e vet se kurrikula e programit të tyre Bachelor Financë- Kontabilitet përafron dhe ka rreth 60-70% të lëndëve në kurrikulë si kurrikulat e programeve të studimit të marra në shqyrtim. GVJ, në përputhje me eksperiencën e vet dhe njohjen që ka për përmbajtjen e programeve të studimit në Financë dhe Kontabilitet në universitete të tjera brenda por edhe jashtë vendit, mbështet pjesërisht gjetjet dhe konkluzionin e analizës së kryer nga Institucioni për nivelin e ngjashmërisë afërsisht 70%.</p> <p>Ndërsa emërtimi dhe larmia e lëndëve të ofruara është e ngjashme me programe të tjera me të njëjtin emërtim, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për ngarkesën në kredite dhe rrjedhimisht edhe numrin e orëve në auditor, sidomos referuar lëndëve të kategorisë B. Programi Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD parashikon më pak orë në auditor për lëndët karakterizuese (të kategorisë B) se programet e tjera të ngjashme të ofruara nga institucione të tjera.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i><a href="#">Analize krahasuese programe studimi te ofruara nga universitetet publike brenda vendit.pdf</a></i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në kohën e hartimit të këtij raporti Institucioni referon se është në fazën e dërgimit të kërkesës për kodifikimin e programit të studimit në përputhje me Udhëzimin nr. 31 të vitit 2022 “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. GVJ e konfirmon këtë mbështetur në dokumentat pjesë e DVV si Kërkesa e Rektorit të UAMD dërguar Drejtuesve të Njërive Kryesore të Institucionit për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga ata dhe përgjigjen e njësisë bazë për kodifikimet e programeve të studimit të ofruara pranë Departamentit të Financë Kontabilitetit ndër të tjera edhe Bachelor Financë Kontabilitet (gjuhë shqipe) – 63BA0411S. Në kohën e vizitës në Institucion, GVJ u informua se Institucioni është ende në pritje të përgjigjes për miratimin e kodit të programit të studimit nga MAS. Përsa i përket kodifikimit të lëndëve të programit, GVJ u informua gjatë</p>



	<p>vizitës në Institucion se ishin duke u kryer procedurat e nevojshme.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Udhëzim nr. 31, datë 15.11.2022 për _Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë_.pdf</i></p> <p><i>Kërkesë për propozime të kodifikimit të programeve të studimit.pdf</i></p> <p><i>Shkresë për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Financë Kontabilitetit.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p><b>Ky kriter nuk ka aplikim për këtë program studimi.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Elementet e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p> <p><i>GVJ është e mendimit se sasia e krediteve të parashikuara dhe orët në auditor për lëndët karakterizuese (kategoria B), paraqitet e pamjaftueshme. Ky standard përmbushet kryesisht duke sugjeruar thjeshtimin e përmbajtjes së programit të studimit përsa i përket numrit të lëndëve të ofruara dhe pasurimin e lëndëve të mbetura për të pasur më shumë kredite (6 – 7) dhe më shumë orë praktikë mësimore (seminare). Ky sugjerim jepet duke mbajtur në konsideratë kufizimet e legjislacionit në fuqi përsa i përket ndryshimeve maksimale të lejuara.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**



**Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

GVJ informohet se UAMD është themeluar në vitin 2005 me VKM nr. 801, dhe hapi studimet për herë të parë në vitin akademik 2006-2007. UAMD është krijuar si institucion sipas Vendimit Nr. 801, datë 20.12.2005, dhe është riorganizuar sipas Vendimit numër 685, dt 25.08.2010 në 5 fakultete:

1. Fakulteti i Edukimit;
2. Fakulteti i Biznesit;
3. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
4. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;
5. Fakulteti i Studimeve Profesionale;

UAMD ka marrë Akreditimin e parë Institucional në bazë të Vendimit Nr. 10, datë 07.04.2017, të Bordit të Akreditimit të ASCAL dhe është riakredituar me Vendimin nr. 18, datë 24.03.2022 nga Bordi i Akreditimit i ASCAL.

Fakulteti i Biznesit në UAMD që ofron programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është hapur me VKM, Nr. 801, dt 20.12.2006. Kur u krijua ai njihej si Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, ndërsa që nga viti 2010 emërtohet si "Fakulteti i Biznesit" (FB) në përputhje me riorganizimin e institucionit.

Programi i Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet është hapur në vitin 2010 me VKM nr. 685, dt. 25.08.2010. Programi i studimit u përshtat me vendim të Senatit Akademik të UAMD nr. 99 dt 14.06.2018 dhe në vitin 2021 u bë edhe riorganizimi i programit me ndryshime të vogla nën 20% sipas vendimit nr. 21 të Senatit Akademik të UAMD, dt. 30.03.2021. Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet aplikon për akreditim për herë të parë. Sipas kërkesave ligjore në fuqi që specifikojnë se "njësia kryesore duhet të organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente", GVJ konfirmon nga organograma se Fakulteti i Biznesit në UAMD, e përmbush këtë kriter pasi ka në përbërjen e tij gjashtë departamente:

1. Departamenti i Financë-Kontabilitet;
2. Departamenti i Menaxhimit;
3. Departamenti i Marketingut;
4. Departamenti i Shkencave Ekonomike;
5. Departamenti i Turizmit;
6. Departamenti i Statistikës dhe i Informatikës së zbatuar;

Në përputhje edhe me tabelat në RVB për këtë program, shihet se departamentet e Fakultetit të Biznesit përmbushin kërkesat ligjore për numrin e stafit akademik efektiv, PAE (cdo njësi bazë duhet të ketë të paktën 7 personel akademik të brendshëm, ndër të cilët 3 të jenë me tituj dhe grada). I vetmi departament që

nuk përmbush këtë kriter është ai i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar i cili, megjithatë nuk është njësia bazë që ofron programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet dhe është department i ri i krijuar vetëm në vitin e fundit akademik (5 PAE). Tabelat më poshtë paraqesin përbërjen e stafit efektiv dhe me kontratë për njësinë kryesore, njësinë bazë dhe stafin e angazhuar në programin e studimit. Pas shqyrtimit të të dhënave në lidhje me stafin, GVJ konstaton se Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD, Fakulteti i Biznesit përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK) sic shihet edhe më poshtë.

Kualifikimi i stafit akademik të	Fakulteti i Biznesit					
	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	5	6	6	6	5	7
Prof. Asoc.	11	11	10	10	13	11
Dr/Phd	43	20	43	17	40	13
Msc.	12	60	13	42	11	38
<b>Gjithsej</b>	<b>71</b>	<b>97</b>	<b>72</b>	<b>75</b>	<b>69</b>	<b>69</b>

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD është Departamenti i Financë-Kontabilitetit. Referuar të dhënave të RVB, GVJ konstaton se kjo njësi bazë përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK). Gjatë vitit akademik më të fundit 2022-2023 (sipas tabelës 1 në RVB) ky departament ka 16 PAE dhe 26 PAK që qëndrojnë në raportet 38%/62%; gjatë vitit akademik 2021 – 2022 janë 17 PAE dhe 32 PAK (35%/65%); gjatë vitit akademik 2020 – 2021 janë 17 PAE dhe 33 PAK (34%/66%). Strukturimi i stafit akademik sipas kualifikimit të tyre paraqitet në detaje në tabelën më poshtë.

	Departamenti Financë Kontabilitet		
	2020-2021	2021-2022	2022-2023

Kualifikimi i stafit akademik të	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	2	2	2	1	2
Prof. Asoc.	1	3		3	1	5
Dr/Phd	10	7	10	7	9	5
Msc.	5	21	5	20	5	14
<b>Gjithsej</b>	<b>17</b>	<b>33</b>	<b>17</b>	<b>32</b>	<b>16</b>	<b>26</b>

**Referenca:**

*VKM nr. 801 datë 20.12.2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës\_Ligjet.org - Për hapjen e universitetit Aleksandër Moisiu në Durrës.pdf*

*VKM nr. 685, datë 25.08.2010 Për riorganizimin e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës .pdf*

*Vendim nr. 10 datë 07.04.2017 i Bordit të akreditimit Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës .pdf*

*Vendimi nr 18, datë 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit dhe Raporti i Vlerësimit Instuticional.pdf*

*Organigrama e Universitetit Aleksandër Moisu.pdf*

*Organigrama Fakultetin e Biznesit.pdf*

*Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat*

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Në bazë të konstatimit në organogramën e Institucionit mund të shihet se UAMD ka angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ për të përmbushur nevojat e përgjithshme të programeve të studimit që ai ofron. Angazhimi i personelit të këtyre kategorive garantohej dhe rregullohet në Rregulloren e Institucionit (seksioni II për personelin ndihmës akademik dhe atë administrativ). Neni 110 i Rregullosës Institucionale parashikon angazhimin e personelit ndihmës akademik në dy kategori: ndihmës akademik mësimor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ. Ata janë në funksion të njësive bazë ku janë atashuar dhe detyrat e tyre janë të përcaktuara në Statutin e UAMD. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor (Statuti i UAMD, neni 52, pika 2). Ndërkohë personeli administrativ (sipas nenit 112 të rregullosës) është pjesë e

	<p>strukturës së përgjithshme të UAMD dhe përcaktohet nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Sipas tabela 1 në RVB FB ka 15 personel ndihmës akademik dhe DFK ka 3 personel ndihmës akademik të angazhuar në vitin 2022 – 2023 dhe 2021 - 2022; FB ka 10 personel ndihmës akademik dhe DFK ka 2 personel ndihmës akademik të angazhuar në vitin 2020 – 2021. Detyrat e përgjegjësitë e personelit akademik me karakter mësimor dhe administrativ përshkruhen me detaje edhe në nenin 12 të rregullores së programit të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Organigrama e Universitetit Aleksandër Moisiu.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Tabelat në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm.</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në nenin 7 të Rregullores së njësisë bazë është parashikuar (ndër të tjera) edhe pozicioni i koordinatorit të programit të studimit si një ndër autoritetet drejtuese të Departamentit të Financë Kontabilitetit. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit parashikohen në nenin 15 të rregullores së njësisë bazë. Sipas këtij neni, koordinatori i programit të studimit, është përgjegjës për raportimin pranë Drejtuesit të njësisë kryesore dhe Drejtuesit të njësisë bazë mbi cilësinë dhe standartet që mbikëqyr; koordinon punën për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik; programeve lëndore (syllabuset), paketën e praktikës profesionale dhe të udhëzimeve për temën e Diplomimit; kujdeset për implementim të të gjitha aktiviteteve të planifikuara në programin e studimit; mban kontakte me bizneset; mbikëqyr aktivitetet e praktikës profesionale dhe organizon procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Memo për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.pdf</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e DVV dhe konfirmoi në vizitën në Institucion se njësia kryesore / bazë që ofron programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD përmbush kërkesat ligjore në lidhje me mënyrën e organizimit në</i></p>

	<i>struktura përbërëse, numrat e stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe nivelin e kualifikimit të tyre së bashku me raportet përkatëse. Gjithashtu, me qëllim përmbushjen e objektivave të programit, Institucioni angazhon personel ndihmës akademik dhe administrativ detyrat e të cilëve përcaktohen qartë në rregulloret përkatëse të institucionit. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ konfirmon sipas përmbajtjes së DVV që Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit disponojnë të dhënat e detajuara në lidhje me organizimin, strukturën dhe elementet në përmbajtje të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet dhe i kanë përfshirë këto elemente në rregulloren e njësisë bazë. Këto elemente janë të përfshira gjithashtu edhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet.  <b>Referenca:</b> <i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i> <i>Evidencë 32. Rregullore e programit të studimit Bachelor.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD (tabela 10 në RVB dhe aneksi në rregulloren e programit të studimit), GVJ konstatoi se ky dokument jep informacion në lidhje me ngarkesën mësimore dhe aktivitetet e lidhura me të, si orët në auditor dhe jashtë auditorit (në terren) dhe mësimin individual për çdo lëndë të organizuar sipas semestrave dhe viteve akademike.  <b>Referenca:</b> <i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i> <i>Evidencë 32. Rregullore e programit të studimit Bachelor.pdf</i> <i>Tabelat e RVB</i>



**Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Përsa i përket pranimeve, transferimeve dhe ekuivalentimeve të studimeve në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, GVJ shqyrtoi rregulloren e programit të studimit ku konfirmon përfshirjen e elementeve të nevojshme. Neni 10, pika 5, dhe neni 28 i rregullores së programit specifikojnë si rregulla të përgjithshme të pranimit se kanë të drejtë të kandidojnë për t'u pranuar në programin e studimit: kandidatët që kanë përfunduar me sukses Maturën Shtetërore dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM; kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj; shtetasit e huaj në kushtet e parashikuara në marrëveshjet dypalëshe. Komisioni ad-hoc i ngritur nga Përgjegjësi i Departamentit vendos rregullat materiale dhe procedurale që do të zbatohen për realizimin e procesit konkret të pranimeve. Rregulla më të detajuara mund të përcaktohen në rregulloret e njëjësive kryesore. Kriteret specifike të pranimit përcaktohen me propozim të drejtuesit të njësisë kryesore dhe miratim nga Senati Akademik në cdo vit akademik dhe lidhen me notën mesatare të lëndëve si Matematikë dhe Ekonomi, ku një koeficient më të lartë kanë kandidatët që vijnë nga një shkollë e mesme profesionale ekonomike. Në lidhje me transferimin e studimeve, UAMD ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve (neni 35, rregullorja e programit të studimit) në të njëjtin cikël studimi e në fusha të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, mund të njihen dhe njësohen nga Ministria përgjegjëse për arsimin, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve janë 30 kredite të fituara. Numri maksimal i krediteve të njohura për programet e studimit në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve përcaktohen në aktet nënligjore në fuqi. Në tabelat e RVB jepet informacion për 5 studentë të transferuar (3 në vitin 2020 – 2021; 2 në vitin 2021 – 2022; dhe 2 në vitin 2022 – 2023).

**Referenca:**

*Rregullore e programit të studimit*

*Per publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023.pdf*

*Mbi kriteret e pranimit të sistemit Bachelor për dep. finance konatbilitet për vitin akademik 2023-2024.pdf*





	<p><i>Transferimet e studimeve.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Ndër dokumentet e dorëzuara në DVV, u shqyrtua dosja e syllabuseve të programit të studimit të ofruara në vite. GVJ gjen që këto programe lëndore janë organizuar kryesisht në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Syllabusi i çdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me praktikën, seminarët (nëse ka) dhe orët e laboratorit (nëse ka) në përputhje kjo me VKM nr.41 si edhe mënyrën e vlerësimit që ndjek çdo pedagog, e cila është përgjithësisht e standardizuar dhe varion në një interval të lehtë nga një lëndë në tjetrën. Nota përfundimtare është rezultante e elementëve të vlerësimit si: ndjekja dhe frekuentimi i lëndës, detyra kurse, teste gjatë vitit (në javën e 7 dhe të 8 të semestrit) dhe provimi përfundimtar.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Syllabuset e lendeve te ofruara ne vite.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Sikurse GVJ konstaton, përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit është një ndër detyrimet dhe përgjegjësitë e personelit akademik në UAMD (Rregullorja e njësisë bazë, neni 17, pika 2). Përditësimi i kurrikulave në dakortësi me dekanatin e Fakultetit dhe në shërbim të njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm dhe përditësimi i syllabuseve janë parashikuar edhe në Strategjinë e njësisë bazë që ofron këtë program studimi.</p> <p>Edhe në RVB për këtë kriter, Institucioni deklaron fokusin e vecantë drejt përmirësimit të programit duke e mbështetur me tabelën 11 në RVB ku dallohen 40 ndryshime në Planin Mësimor. Pavarësisht se bëhet fjalë për kryesisht ndryshime të kohës (vitit/semestrit) të ofrimit të lëndës ose numrit të krediteve, dhe jo ndryshime thelbësore, GVJ është e mendimit se numri i ndryshimeve është i lartë. Në kuadër të riorganizimit të programit të studimit, megjithatë mund të arsyetohet se ka qenë e nevojshme që të realizohet me sukses si proces. Si procedurë, përmirësimi i përmbajtjes së programit iniciohet nga pedagogët e lëndës të cilët pasi e diskutojnë në mbledhje departamenti dhe marrin dakordësinë e njësisë bazë, e përcjellin më tej për shqyrtim dhe miratim në Dekanat. Gjatë vizitës në Institucion u konfirmua ndjekja e kësaj praktike me stafin akademik të anagazhuar në këtë program studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p>


	<p><i>Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025 .pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>Evidencë 29. Vendim i Senatit Akademik nr 99 dt. 14_06_2018 për riorganizimin e programit të studimit _Finance Kontabilitet_.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 19. Vendim i Senatit Akademik nr. 21 dt 30.03.2021 për Riorganizimin nën 20% të programit të studimit bachelor Financë Kontabilitet .pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD përmban elementet e nevojshme të Planit Mësimor. Në program janë përfshirë edhe informacionet e nevojshme për syllabuset e cdo lënde dhe komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD konfirmohet nga GVJ se është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm sipas një procedure që përputhet me rregulloret përkatëse. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ, duke gjykuar në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni, dhe kryesisht Plani Mësimor i programit të studimit dhe programet lëndore gjykon se tërësia e lëndëve të përfshira në program mundëson dhënien e njohurive të nivelit 6 të KSHK, pra aftësim për problem zgjidhje mesatarisht komplekse në praktikë. Këto aftësi dhe njohuri garantojnë kryesisht punësimin e studentëve në tregun vendas të punës në përputhje me nevojat e punëdhënësve për ekonomistë dhe financiarë.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

	<p><i>Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Tabelat permbljedhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Dhënë objektivat formues të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet që në rregulloren e programit citohen të jenë: “përgatitja e studentëve me aftësi për pozicionim në karrierën profesionale në kontabilitet dhe drejtim financiar; formimi i specialistëve të fushës së menaxhimit, analizës financiare dhe kontabël me nivel të lartë në aftësi profesionale dhe përgjegjësi sociale; kombinimi i dijeve teorike me aftësi konkrete për të zbatuar në praktikë konceptet teorike dhe përgatitja e studentëve për të vazhduar studimet në ciklin master”.GVJ është e opinionit se numri i orëve dhe i krediteve të secilës prej lëndëve të programit mundëson vetëm kryesisht arritjen e këtyre objektivave formuese.</p> <p><i>GVJ është e mendimit se për lëndët e rëndësishme në funksion të arritjes së objektivave (si kontabiliteti dhe financa), pra konkretisht lëndët karakterizuese (kategoria B) duhet të ishin <u>parashikuar më shumë kredite (të paktën 6).</u></i></p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Financë Kontabilitet</i></p> <p><i>Tabelat permbljedhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ shqyrtoi me vëmendje të shtuar dokumentacionin në RVB për t’u shprehur në lidhje me raportin mes teorisë (orë leksione në auditor) dhe praktikës (orë seminare dhe praktikë profesionale) për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. GVJ konstaton se tabela 13 në RVB nuk ka të ndara format e mësimdhënies mes leksione dhe seminare dhe për këtë u kërkua më shumë informacion pas vizitës në terren. Drejtues dhe stafi u shprehën se në përputhje në përputhje me statutin (neni 72, pika 4.c) dhe rregulloren e institucionit (neni 60, pika 5.c) janë parashikuar orë mësimore të integruara pa një ndarje në leksione dhe seminare dhe i është lënë një liri akademike stafit për të organizuar orët mësimore në varësi të nevojave të lëndës. Vetë studentët u shprehën se lëndët ofrojnë aktivitete praktike si ushtrime, projekte kursi, detyra shtëpie dhe klase ku diskutohen gjerësisht konceptet e nevojshme për të kuptuar sa më mirë lëndën.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Tabelat permbljedhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Statuti i UAMD</i></p>



	<i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja teori (leksione) dhe praktikë (seminare /laboratore /praktika) në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD, sipas tabelës 13 në RVB është si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1710 orë mësimore të integruara (leksione, seminare, forma kontrolli të vazhdueshme);</li> <li>- 75 orë praktika profesionale;</li> <li>- 1785 orë në total;</li> </ul> <b>Referenca:</b> <i>Tabelat permbljedhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i>
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Sic është parashikuar edhe në Strategjinë e njësisë bazë që ofron këtë program studimi, përditësimi i vazhdueshëm i kurrikulave në shërbim të njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm dhe përditësimi i syllabuseve është një ndër prioritetet e njësisë bazë për programet ekzistuese të studimit, përfshi edhe programin Bachelor në Financë Kontabilitet. Ndërkohë në RVB citohet organizimi i Panairit të Punës dhe Forumit si një ndër instrumentet për përmirësimin e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.  Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të syllabuseve që ishte një praktikë e zakonshme e njësisë bazë në cdo fillim viti akademik. Nga analiza e përmbajtjes së syllabuseve në dosjen e programeve lëndore, GVJ konstaton edhe përdorimin e literaturës, kryesisht të viteve të fundit, me përjashtime të vogla që nuk çënojnë cilësinë e materialeve që ofrohen për studentët e këtij programi studimi. Ky kriter përmbushet plotësisht.  <b>Referenca:</b> <i>Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025 .pdf</i> <i>Dosja e syllabuseve</i> <i>Vizita në Institucion</i>
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Bazuar në analizën që GVJ i bëri përmbajtjes së programit të studimit dhe më konkretisht, syllabuseve të tij për të tre vitet arrin në përfundimin se ofrohen shumë lëndë secila prej tyre me pak kredite.



<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p><i>GVJ sugjeron pakësimin e numrit të lëndëve ndoshta duke kaluar disa prej tyre si lëndë me zgjedhje (si Kontabiliteti Publik, Kontabiliteti i Institucioneve financiare, etj), ose të lihen si lëndë që ofrohen në nivele studimi më të thelluara të ciklit të dytë, dhe thellimin e lëndëve kryesore duke shtuar numrin e orëve në praktikë mësimore / seminare dhe rrjedhimisht edhe numrin e krediteve. Kjo do të ndihmojë studentët të përthithin më mirë njohuritë e reja dhe të arrijnë të kenë kompetencat e synuara për t'u punësuar dhe për të vazhduar studime të mëtejshme të ciklit të dytë.</i></p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Syllabuset e lendeve te ofruara ne vite.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Ky standard përmbushet kryesisht për shkak se numri i lëndëve të ofruara në programin e studimit është tejet i lartë duke përfshirë lëndë që mund të ofrohen me zgjedhje (ose të lihen për nivele më të thelluara studimi) dhe cdo lëndë ka pak orë mësimi në auditor. Për shkak të numrit të lartë të lëndëve, secila prej tyre ofrohet në numër kreditesh të kufizuar (maksimumi 5 ECTS), që, në gjykimin e GVJ nuk mjafton që studentët të aftësohen plotësisht për punësim dhe vazhdim të mëtejshëm të studimeve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi II.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin</p>	<p>Referuar deklarimeve të Institucionit në RVB, mendimet dhe opinionet e institucioneve partnere merren parasysh në kuadrin e organizimit të Panairit të Punës dhe Forumit si edhe statistikat për punësimin e studentëve alumni të UAMD. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ formoi përshtypjen se Institucioni vërtet gëzonte bashkëpunim të ngushtë me institucionet partnere dhe reflekton sugjerimet e tyre në përfitim të ecurisë së programit të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

<p>parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p><i>Evidencë 33. Analiza ecurise dhe studimi i tregut te punes.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se sipas rregullores së njësisë kryesore (neni 84, pika c) është parashikuar që studentët të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së njësisë kryesore, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.</p> <p>Po kështu, GVJ ndeshi evidencë për përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të mësimit dhe të profesoratit nëpërmjet pyetësorëve, një model i të cilëve dhe rezultatet përkatëse ishin pjesë e DVV. Megjithatë institucioni nuk ka siguruar evidencë që faktin se realisht sugjerimet e studentëve të jenë reflektuar kur ato kanë qenë në ndihmë të programit të studimit. Po kështu, të dhënat në DVV nuk lidhen me studentët alumni por me studentët aktualë. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u vu në dijeni nga stafi akademik se studentë alumni të programit të studimit merrnin pjesë në aktivitetet e organizuara nga Institucioni ku edhe shprehnin opinionet e tyre në funksion të përmirësimit të programit. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullorja e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Pyetësoni i studentëve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Në këtë kriter, në RVB institucioni deklaron se mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka me partnerë të ndryshëm, garanton edhe përfshirjen e tyre në përditësimin dhe përshtatjen e kurrikulës së programit të studimit. Në DVV gjendet edhe një analizë e marrëveshjeve të njësisë bazë, madje edhe një pyetësor që i është shpërndarë ekspertëve për përmirësimin e kurrikulave, por pa patur dokumentacion që faktin reflektimin e sugjerimeve të përfutuara. Gjatë vizitës në Institucion u diskutua në lidhje me praktikën që ndiqen për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit sipas sugjerimeve të rrjetit të bashkëpunëtorëve dhe GVJ formoi bindjen se Institucioni angazhohet maksimalisht në drejtim të kësaj praktike. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Analize e Marreveshjeve Dep. FK, V.A 2021-2022.pdf</i> <i>Pyetesor shperndare eksperteve per permiresimin e kurrikulave_BACHELOR.docx</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>




<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ gjykon se ky standard përmbushet plotësisht pasi marrëveshjet e bashkëpunimit në UAMD janë funksionale, analizohen dhe mendimet dhe sugjerimet partnerëve institucionalë merren në konsideratë duke shfrytëzuar një larmi mënyrash si pjesëmarrje në Panairin e Punës, Forum, etj. Po kështu, institucioni vlerëson dhe merr në konsideratë sugjerimet e studentëve dhe të rregullatorëve të tregut dhe shoqatave profesionale të financë kontabilitetit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, format e mësimdhënies janë orët e mësimi leksione; orët e mësimi seminare; orët e mësimi të integruara të leksioneve dhe seminareve; projekte dhe detyra kursi individuale ose në grup; provime të ndërmjetme dhe përfundimtare; praktika profesionale e zhvilluar në laboratorë të UAMD ose në institucione dhe kompani me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi. (Rregullorja e programit të studimit, neni 15, pika 3 dhe rregullorja e UAMD, neni 60, pika 5). Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi këto forma të mësimdhënies, dhe u informua se ndarja e orëve të integruara në auditor, konkretisht në leksione dhe në seminare lihej në zgjedhjen e lirë të pedagogut të lëndës në varësi të fokusit të cdo lënde. Në opinionin e GVJ, ky kriter përmbushet plotësisht.  <b>Referenca:</b>



	<p><i>Rregullore e programit te studimeve cikli i pare 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Format e ndryshme të mësimdhënies të parashikuara në rregulloren insituacionale dhe atë të programit të studimit, respektohen nga ana e stafit akademik, sikundër u konfirmua nga GVJ gjatë bisedave me stafin por edhe me studentët. Në DVV u gjet edhe evidencë shkresore në dokumentin përmbledhëse e metodave interkative të mësimdhënies, cka formon bindjen tek GVJ se studentëve në UAMD u ofrohen metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studentët u shprehën se ata ndjehen të përfshirë në procesin e mësimin dhe janë të nxitur të marrin pjesë në diskutime dhe në detyra individuale dhe në grup.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Evidencë 34. Metodat interaktive të përdorura për mesimdhëni.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ është e mendimit se UAMD mbështet personelin e tij akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike duke i përfshirë në trajnime dhe aktivitete të ndryshme si edhe në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit që ka lidhur me institucione te tjera të arsimit të lartë. Në DVV u gjetën dokumenta që mbështesin politikat nxitëse insituacionale për stafin akademik dhe kjo u konfirmua edhe nga vetë stafi gjatë vizitës në Institucion. Ata u shprehën se kanë mundësi të trajnohen dhe marrin pjesë në aktivitete kërkimore dhe leksione të hapura që janë në funksion të përmirësimit të aftësive të tyre didaktike.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Lista e marrëveshjeve në kuadër Institucional të UAMD.pdf</i></p> <p><i>Workshop organizuar për Stafin Akademik nga Fakulteti Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Lista e marreveshjeve bilaterale per shkembime.docx</i></p> <p><i>Aktivitete Fakulteti Biznesit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive</p>	<p>Gjatë diskutimeve me stafin akademik, GVJ u informua se lektorët përfshijnë gjatë procesit mësimor metoda të larmishme për të shpjeguar sa më mirë konceptet teorike dhe për t'i ilustruar ato me raste praktike. Diskutimet me studentët ishin një ndër format me të cilat nxitej edhe përfshirja e studentëve</p>

<p>dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>në klasë dhe bashkëpunimi me njëri tjetrin. Këto metoda interaktive rrisin mendimin kritik dhe ndjenjën e pavarësisë dhe iniciativës në problemzgjdhje.</p> <p>Në përgjithësi GVJ formoi opinionin se metodat e mësimdhënies të aplikuara nga stafi i UAMD për programin e studimit, ishin metodat e duhura për të mundësuar një proces mësimi cilësor drejt arritjes së objektivave të programit të studimit. Vetë studentët u shprehën se në ndihmë të tyre ishin aksesit në materiale të bollshme, ilustrimi i koncepteve teorike me situata praktike nga ana e pdeagogëve të lëndës, afria me ta që krijonte lirinë e të shprehurit në klasë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Evidencë 34. Metodatat interaktive të përdorura për mesimdhëni.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>GVJ konfirmoi gjatë diskutimeve me stafin e angazhuar në program se Institucioni aplikonte si praktikë pune përditësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore. Studentët përfshihen në këtë proces nëpërmjet pyetësorit të zhvilluar me ta në përfundim të çdo semestri. Pavarësisht se dokumentacioni në DVV për këtë kriter është i vjetëruar pasi i referohet viteve akademike 2018 – 2019 ose 2019 – 2020, GVJ e konfirmoi praktikën e përfshirjes së studentëve në procesin e përmirësimit të procesit mësimor gjatë vizitës në Institucion. Pavarësisht se deri më tani studentët u shprehën të kënaqur me nivelin e njohurive të marra, ata konfirmuan se në rastin e kërkesave të tyre, janë përballur me fleksibilitet nga ana e profesoratit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Pyetësori i studentëve.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit</p>	<p>Në UAMD janë ngritur dhe funksionojnë grupet mësimore kërkimore të cilat organizojnë punën në njësitë bazë në funksion të arritjes së objektivave ofrmuese të programeve të studimit përkatëse. Po kështu, Institucioni ka ngritur një set strukturash të dedikuara për përmirësimin e cilësisë (neni 2 i rregullores së cilësisë). Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: Senati Akademik; Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC); Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC); Koordinatori Institucional</p>



<p>të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>pranë ASCAL (KIAL); Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC). Në nivel njësie kryesore përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBACHELOR Fakulteti); Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program, dhe Koordinatorët e Programeve të Studimeve. GVJ pati mundësinë të konfirmonte gjatë vizitës, punën e kryer nga këto struktura në drejtim të zhvillimit të metodave të reja dhe trajnimin e stafit akademik.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Ngritje grupi kerkimor mësimor lektorët e departamentit Financë-Kontabilitet 2021.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konfirmon përmbushjen plotësisht të këtij standardi mbështetur në gjetjet në DVV dhe gjatë vizitës në institucion, në lidhje me iniciativat e vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë duke marrë parasysh mendimet e studentëve aktualë dhe alumni, partnerëve të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe në orientimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të strukturave të brendshme të përmirësimit të cilësisë në UAMD.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit (neni 23) parashikohen mënyrat e vlerësimit të njohurive në lëndët e ofruara në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Format e kontrollit në UAMD kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit (provime të ndërmjetme në javët 7 dhe 8 të semestrit, dhe detyra kursi) me atë përfundimtar (provimi me shkrim në javën e 15 dhe 16). Për çdo lëndë, 10% e vlerësimit bazohet në detyrat dhe projektet e kursit në mënyrë individuale apo në grupe. Në format e kontrollit përdoret vlerësimi me pikë, shuma e të cilave përkthehet në notë sipas formulës së</p>



<p>posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>përcaktuar në rregulloren Institucionale dhe të përmendur edhe në tabelën 14 në RVB. Në lidhje me provimet, Institucioni ka hartuar edhe një rregullore të posaçme për provimet në të gjitha ciklet e studimit. GVJ konstatoi gjatë vizitës në Institucion se studentët e programit të studimit njiheshin me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve të tyre në përfundim të lëndës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e programit te studimeve cikli i pare 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Provimeve të FB.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga diskutimet me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lënde me përmbajtjen e saj, pra me temat që do zhvillohen, materialet mësimore dhe mënyrën e shpërndarjes së tyre, detyrimet për frekuentimin e lëndës dhe detyrat specifike si projekte, detyra kursi apo ese. Elementet që lidhen me testimin e dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore u dërgohen studentëve edhe nëpërmjet postës elektronike. Shtjellimi i syllabusit në orën e parë të mësimit ishte një aktivitet i zakonshëm që u konfirmua gjatë vizitës edhe nga studentët, edhe nga stafi akademik.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren e programit të studimit përsa i përket mënyrës së testimit të njohurive (neni 14 &amp; 15) dhe sikurse është përfshirë në të gjitha syllabuset e lëndëve të shqyrtuara nga GVJ, dhe gjithashtu edhe konform tabelës së përmbledhur 15 në RVB shihet se format e kontrollit të dijeve për këtë program studimi janë: Detyrat e kursit (10%); Testimet gjatë vitit (40%) dhe provimi përfundimtar (50%). GVJ është e bindur se me këtë mënyrë të kompozimit të shlyerjes së detyrimeve, studentët kanë mundësi të tregojnë aftësitë e tyre në modalitete të ndryshme, me shkrim (provimet) dhe me gojë (prezantimi i projekteve të kursit), në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit duke mos krijuar varësi nga një mënyrë e vetme e testimit në një kohë të vetme.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e programit te studimeve cikli i pare 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ konfirmoi me studentët gjatë vizitës në Institucion se ata inkurajohen të japin sugjerimet e tyre mbi kriteret e vlerësimit të kursit para se kjo e fundit të finalizohet, nëpërmjet një pyetësoi anonim. Rezultatet e këtij pyetësoi përfshihen në analizën vjetore të kryer nga njësia bazë e cila ngre një grup pune të posacëm për këtë qëllim. GVJ konfirmoi analizën e kryer nga Institucioni dhe shkallën e përfshirjes së studentëve në të duke u shprehur se ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Pyetësoi i studentëve.pdf</i></p> <p><i>Vendim ngritja e grupit te punes per analizen e departamentit.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga sa u evidentua nga bisedat me studentët e programit të studimit, mënyra e organizimit të procesit mësimor ishte e tillë që inkurajon përdorimin e metodave të larmishme për përcimin e dijeve tek studentët. Detyrat dhe projektet individuale dhe në grup nxisin punën e pavarur tek studentët duke i vendosur ata në kushte të supozuara pune në terren. Në përgjithësi GVJ formoi bindjen se mënyra e organizimit të orëve të mësimi dhe mundësimi nga ana e Institucionit e sallave të pajisura në mënyrë të përshtatshme nga ana multimediale, mundëson përfundimin e njohurive dhe përmbushjen e objektivave formuese të programit të studimit. Stafi u shprehën të motivuar nga niveli i angazhimit dhe interesimit të studentëve të programit por edhe studentët u shprehën entuziastë për eksperiencën që kishin në aktivitetet mësimore dhe kërkimore dhe mbështetjen e vazhdueshme që merrnin nga profesorët e tyre.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD ka hartuar rregullore të posacme për programin e studimit në të cilën përshkruhen në mënyrë të detajuar detyrimet e studentëve dhe mënyrat e vlerësimit të tyre. Vlerësimi i njohurive është i shpërndarë përgjatë gjithë semestrit. Stafi dhe studentët punonin së bashku në ambiente ndërtuese që nxisin komunikimin e hapur dhe ndihmojnë arritjen e objektivave dhe synimeve të kursit. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga tabelat në RVB (tabela 15), GVJ konstaton se format e kontrollit të dijeve për këtë program studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Detyrat e kursit (10%);</li> <li>- Testimet gjatë vitit (40%);</li> <li>- Provimi përfundimtar (50%);</li> </ul> <p>të cilat janë të shtrira gjatë gjithë semestrit në të cilin zhvillohet lënda, ashtu edhe sikurse parashikohet në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i këtyre komponentëve gjendet edhe në syllabuset e lëndëve të programit të studimit, aq sa GVJ shqyrtoi dosjen e syllabuseve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e programit të studimeve cikli i parë 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Tabelat përmbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Syllabuset e lendeve të ofruara në vite.pdf</i></p> <p><i>VITI 2022-2023 syllabuset bsc fk.zip</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter, Institucioni shprehet se ka përdorur forma elektronike të vlerësimit si Platforma CleanScore, dhe platforma Teams, gjatë kohës së pandemisë. GVJ ndeshi evidencë në DVV vetëm për njoftimet përkatëse për përdorimin e platformave, dhe u informua gjatë vizitës në Institucion se pjesëtarë të stafit akademik përdorin metodat elektornike të vlerësimit për të garantuar një vlerësim sa më të drejtë të rezultateve dhe njohurive të studentëve. Mbështetur në këto evidence, GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Email Njoftim Clean Score_dixhitalizimit të procesit të zhvillimit të provimeve.pdf</i></p> <p><i>Njoftim per perdorim te platformes Microsoft Teams.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës</p>	<p>Në nenin 2 të Rregullores së provimeve në UAMD thuhet se vlerësimi përfundimtar i lëndës kryhet duke u bazuar në</p>

<p>bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë: a) Provimi i parë i ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e 7 ose 8 të semestrit dhe që përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar; b) Provimi përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e 15 ose 16 dhe që përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar; c) Detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit, aktivizimi gjatë orëve të mësimi, dhe që përmbajnë 100 pikë ose 10% të vlerësimit përfundimtar.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e provimeve në UAMD</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sic GVJ konfirmon nga rregullorja e provimeve, pas nxjerrjes së rezultatit bëhet ballafaqimi i vlerësimit në mënyrë që të sigurohet transparenca e tij. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik i lëndës cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Nuk lejohet dhënia e informacionit mbi rezultatet e provimeve për asnjë person tjetër, përveç studentit që ka kryer provimin. Kjo praktikë u konfirmua se aplikohet edhe nga studentët e programit të studimit, gjatë vizitës në Institucion të cilët u shprehën se kishin mundësi të njiheshin me vlerësimin e detajuar të dijeve të tyre dhe me një koment mbi mundësinë e përmirësimit në të ardhmen.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e provimeve në UAMD</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>“Rregullorja e Provimeve”, parashikon si rregulla të përgjithshme të kryerjes së provimeve sa më poshtë: gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës; nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi; nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës; personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit; në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi</p>

	<p>në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës; gjithashtu procesverbalit i bashkëngjitet provimi i cili vlerësohet me 0 pikë; në përfundim të çdo sezoni provimesh ose riprovimesh sekretaria mësimore dërgon pranë Zv.Dekanit mësimor listën e studentëve të penalizuar; dekani, bazuar në parregullsinë e konstatuar merr një vendim mbi masat e mëtejshme disiplinore që do të zbatohen rast pas rasti bazuar në shkeljet e konstatuara. Këto masa të parashikuara në rregullore, në gjykimin e GVJ synojnë të dekurajojnë aktivitete të tilla si plagjiatura apo qëndrime jo etike gjatë kontrollit të njohurive. Gjatë vizitës në Institucion dhe diskutimeve me stafin dhe studentët, GVJ formoi përshtypjen se Institucioni UAMD ndjek praktika rigorozë për të evituar maksimalisht plagjiaturën në provime.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e provimeve në UAMD</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Konfirmuar gjatë vizitës në Institucion, dhe në mbështetje të Rregulloreve të Institucionit, procedura e publikimit të rezultateve të kontrollit parashikon afate të cilat në përgjithësi ndiqen nga ana e Departamentit. Sipas rregullores së provimeve në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik i lëndës cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme. Pas provimit personeli akademik i lëndës dorëzon pranë sekretarisë mësimore procesverbalin e rezultateve të shkarkuar nga sistemi, si dhe në një zarf të mbyllur tezat e korrigjuara së bashku me tezat origjinale brenda afateve të përcaktuara. Procesverbali me notat përfundimtare nënshkruhet nga personeli akademik, sekretarja mësimore, kryesekretarja, Drejtuesi i njësisë bazë dhe Drejtuesi i njësisë kryesore. Në rastet e hedhjes së pikëve gabim, personeli akademik i drejtohet me kërkesë Drejtuesit të Njësisë Kryesore, brenda 3 ditëve kalendarike nga dita e hedhjes së procesverbalit. Procesverbalet origjinale përfundimtare të firmosura, depozitohen në sekretari. Provimet ruhen në sekretarinë mësimore sipas afatit të përcaktuar nga Rregullorja për arkivimin e dokumentacionit në UAMD dhe GVJ mundi të dëshmonte ndjekjen e kësaj praktike gjatë vizitës në Institucion. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p>



	<p><i>Rregullore e provimeve në UAMD</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni ka parashikuar procedurë të posacme në lidhje me ankimimin e rezultateve të provimeve (Rregullorja mbi provimet). Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i Njesisë Kryesore kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te Drejtuesi i Njesisë Kryesore një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit Drejtuesi i Njesisë Kryesore vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit. Në rastin kur kërkesa refuzohet studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë të konfirmonte këtë praktikë pune.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e provimeve në UAMD</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas Rregullores së provimeve, në rast se kërkesa për rishikim nga ana e studentit pranohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës nëse lënda mbulohet nga vetë Departamenti. Në rast se lënda mbulohet nga një njësi tjetër kryesore, Drejtuesi i Njesisë Kryesore i kërkon kësaj njësie përbërjen e komisionit të ngritur nga Drejtuesi i asaj njësie. Përgjegjësi i Departamentit përcakton ditën dhe orën se kur do mbledhet komisioni të posaçëm jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit dhe studentin. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëhere ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e provimeve në UAMD</i></p>



	<i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet për përmbushjen në shkallë të plotë të këtij standardi pasi mbështetur në dokumentacion dhe konfirmuar edhe gjatë vizitës në Institucion, UAMD për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet aplikon metoda vlerësimi plotësisht në përputhje me rregulloret përkatëse dhe syllabuset e lëndëve. Procedurat e vlerësimit zhvillohen brenda afateve, në përputhje me parashikimet në rregullore dhe janë transparente duke garantuar vlerësim të drejtë të studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


#### **Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Gjatë shqyrtimit të Planit Mësimor dhe syllabuseve të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet u vu re se ky program studimi ofron dukshëm një larmi të lëndëve të fushave bazë financë, kontabilitet por edhe të fushave të lidhura me to, si ekonomi, marketing, menaxhim, etj. Ndërsa dhënia e shumë njohurive në shumë disiplina është pa diskutim e dëshirueshme dhe pozitive, GVJ konstaton se për shkak të përfshirjes së caq shumë lëndëve në planin mësimor, secila prej tyre kishte rreth 4 – 5 kredite dhe asnjë prej tyre nuk kishte më shumë se 45 orë në auditor.</p> <p><i>Sic GVJ e ka shprehur edhe më lart në këtë raport (standardet II.1 dhe II) opinionin e vet, koha dhe hapësira që u lihet studentëve në dispozicion për problemzgjdhje dhe diskutim në klasë, <u>nuk garanton apo mundëson thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në shkallën sipërore të mundshme.</u></i></p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Syllabuset e lendeve te ofruara ne vite.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit te studimeve cikli i pare 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>GVJ konstaton (nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe i syllabuseve të Programit të Studimit) se ky program mundëson thellimin e njohurive në mënyrë të përgjithshme në fushën e teknologjisë së informacionit (nëpërmjet dhënies së njohurive mbi informatikën në lëndën me të njëjtin emër) si edhe në aspektet e komunikimit dhe ndërveprimit (lëndët e anglishtes së biznesit, shkrimi akademik, etj). Po kështu, në Planin Mësimor ofrohet si lëndë me zgjedhje edhe Etika e Biznesit që sipas GVJ është një pikë e fortë pasi mundëson dhënien e parimeve etike në gjykimin profesional dhe vendimmarrjen me integritet të profesionistëve të së ardhmes.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Syllabuset e lendeve te ofruara ne vite.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmyllëse.</p>	<p>Në programet lëndore, dhe në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41, GVJ vrojton se përfshihet një element të rëndësishëm i cili është “Rezultatet e të nxënit nga studentët” dhe që tregon përfitimet nga cdo lëndë. Gjithashtu sipas strukturës së organizimit të orëve mësimore (leksione dhe seminare) duket se ora e fundit në program është “përsëritje e lëndës” seancë gjatë së cilës bëhet një rikujtesë e objektivave të të mësuarit dhe shihet sa janë përfituar ato nga studentët.</p> <p>Nga ana e studentëve të programit, u konfirmua praktika e përsëritjes së njohurive përpara organizimit të provimit përfundimtar të cdo lënde, dhe madje edhe para provimit të ndërmjetëm në mes të semestrit. Staf i akademik ishte i hapur të orientonte studentët në lidhje me pyetjet apo pasiguritë që ata mund të kishin para detyrimeve të ndërmjetme dhe përmyllëse të cdo lënde.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Model Syllabusi në Bachelor FK Baza Finance V.A. 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Model Syllabusi v.a 2021-2022 Financat Personale.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik</p>	<p>Sipas Planit Mësimor të programit të studimit, në semestrin e fundit të studimeve, ofrohet praktikë profesionale për studentë për të aftësuar më mirë ata për tregun e punës. Gjatë vizitës në Institucion GVJ pati mundësinë të konfirmojë faktin e përfshirjes së praktikave profesionale në kurrikulën e riparë rishtazi nga ana e njësisë bazë. Gjithashtu, gjatë vizitës në Institucion në diskutime me stafin e anagzhuar në programin e studimit, GVJ u informua për suportin e vazhdueshëm të tyre</p>

<p>mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në diskutime gjatë orëve të mësimin. Ata u shprehën të hapur për të krijuar atmosferë pozitive dhe mbështetëse bashkëpunimi për zhvillimin e ideve të reja edhe duke angazhuar lektorë të ftuar apo të tjerë të ftuar nga bota e biznesit dhe institucioneve partnere, shpeshherë edhe student alumni të programit. Studentët nxiten gjithashtu të marrin pjesë në aktivitete plotësuese të njohurive teorike (si konkursi me fokusin në Bursën Virtuale të Titujve, pjesëmarrje në konferencën studentore ku ndaheshin edhe cmime materiale për punimet më të mira, botime në revista shkencore, etj), si edhe të aplikojnë për mobilitete dhe shkëmbime me institucione partnere jashtë vendit, dhe kjo garantohej edhe në Rregulloren e programit të studimit (neni 18). Këto aktivitete, në gjykimin e GVJ, zgjerojnë horizontin e studentëve dhe i nxisin të jenë më këmbëngulës për arritjen e objektivave formues të programit.</p> <p>Dhënë tërësinë e realizimit të mësimin, bashkëpunimimin me institucionet partnere për mobilitetin e stafit dhe studentëve,</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Pjesëmarrjet e studenteve në programet Erasmus +.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimeve cikli i parë 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Tabelat përmbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Aktivitete Fakulteti Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Pjesëmarrje e studenteve konkurs me teme Bursa Virtuale e Titujve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Sikurse specifikon tabela nr. 20 në RVB, janë organizuar 8 orë leksione dhe seminare me lektorë të huaj në kuadrin e marrëveshjeve dhe shkëmbimeve Erasmus + dhe në funksion të përfitimit të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD. Mbeshtetur edhe në të dhëna të DVV që përshkruajnë aktivitete të ndryshme në Fakultetin e Biznesit, si edhe në konfirmimin nga ana e studentëve të programit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Tabelat përmbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Aktivitete Fakulteti Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet i ofruar në UAMD është i organizuar kryesisht mirë përse i përket mënyrës së qasjes dhe aftësimin të studentëve. GVJ është e mendimit se për shkak të numrit të lartë</i></p>



	<i>të lëndëve të ofruara, përmbajtja e programit të studimit paraqitet e ngarkuar me numër lëndësh ku secila prej tyre nuk është e thelluar dhe nuk jep mundësinë e thellimit në njohuri duke ofruar pak orë mësimi në auditor. Për këtë arsye, GVJ është e mendimit se ky kriter përmbushet vetëm kryesisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Për procesin e diplomimit studentët e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet në UAMD i nënshtrohen ose një provimi të përgjithshëm, ose nëse kanë një mesatare më të lartë se nota 7 (shtatë) gjatë tre viteve të studimeve përgatisin një punim diplome. Procedurat për organizimin e provimit dhe diplomën përcaktohen në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit (neni 36), Rregulloren e programit të studimit (nenet 20, 21 dhe 22) si edhe në Rregulloren e posaçme për detyrimet përmbyllëse në nivelin Bachelor. Këto rregullore u bëhen me dije studentëve të cilët, të pyetur gjatë vizitës në Institucion u shprehën të informuar në lidhje me mënyrën e diplomimit në këtë program studimi. Sipas informacionit të gjetur në këto dy dokumente, studentët të cilët plotësojnë kushtet për të përgatitur një punim diplome, paraqesin pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Biznesit një kërkesë për t'u regjistruar për mbrojtjen e tezës së diplomës pasi kanë shlyer të gjitha detyrimet përkatëse.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve Permbyllëse Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit te studimeve cikli i pare 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni argumentohet se studentët udhëzohen vazhdimisht nga udhëheqësit e temave të diplomave. GVJ hasi të përshkruar formalisht mënyrën e</p>



<p>studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>përzgjedhjes apo caktimit të pedagogëve udhëheqës në përputhje me Rregulloren e posacme të detyrimeve përmbyllëse në nivelin Bachelor. Në DVV u gjetën edhe dokumenta për komunikimin e shkruar mes pedagogut udhëheqës dhe studentëve. Për më tepër, gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga stafi akademik se ata mbajnë lidhje të ngushta me studentët që mentorojnë përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të procesit të mbikëqyrjes. Studentët u shprehën se kishin akses në biblioteka fizike dhe elektronike dhe mund të shfrytëzonin literaturën në funksion të përgatitjes së diplomës dhe provimit përfundimtar.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve Përmblylles Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Email per udheheqjet e temave te diplomes.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në DVV u gjet evidencë për ngritjen dhe miratimin e komisioneve të posacme për mbrojtjen e punimit të diplomës dhe për organikzimin e provimit final përmbyllës.</p> <p>Komisionet për mbrojtjen e diplomave apo për administrimin e provimit final në programet e studimit të ciklit të parë përbëhen nga një kryetar dhe dy anëtarë për të garantuar shumicën në marrjen e vendimit për notën përfundimtare të studentit. Në Rregulloren e detyrimeve përmbyllëse të studimeve Bachelor përshkruhet edhe mënyra e përgatitjes për provimin përfundimtar. Neni 2, Kreu II, i rregullores për shlyerjen e detyrimeve përmbyllëse, parashikon se në provimin përfundimtar përfshihen gjashtë pyetje për cdo lëndë të tipologjisë B (pra lëndë karakterizuese). Këto pyetje dorëzohen pranë njësisë bazë e cila ia vendos në dispozicion studentëve. Në vijim studentët që diplomohen me provim përmbyllës i nënshtrohen 12 seancave përgatitore në funksion të provimit. Drejtuesi i njësisë bazë propozon një komision me tre anëtarë për cdo 35 studentë që diplomohen nëpërmjet provimit. Tre anëtarët e komisionit përpilojnë tezat duke u bazuar në pyetjet e dorëzuara paraprakisht pranë njësisë bazë dhe u vihen në dispozicion nga lektorët përkatës celësat e zgjidhjes për pyetjet që do të përfshihen në provim. Gjatë zhvillimit të provimit përpilohen të paktën katër teza për cdo program studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve Përmblylles Bachelor.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p><i>Vizita në Institucion.</i></p> <p>Në mbështetje të bisedave me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ata ishin të asistuar nga personeli akademik gjatë procesit të diplomimit, edhe kur i nënshtroheshin një provimi të përgjithshëm, edhe nëse përgatisnin një punim diplome.</p> <p>Drejtuesit e tezave të diplomave propozohen dhe miratohen nga njësia bazë dhe lista i dërgohet Drejtuesit të njësisë kryesore. Udhëheqësi i diplomës duhet të ketë të paktën një titull shkencor më lart, (pra në rastin e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, duhet të jetë me titullin MSC). Udhëheqësi kontakton me email në mënyrë të vazhdueshme me studentët si edhe takohet disa herë gjatë semestrit me ta për të mbështetur në punimin e diplomës dhe për të sqaruar paqartësitë e tyre. Para se studenti të dalë para komisionit për punimin e diplomës, udhëheqësi duhet të japë miratimin dhe të bëjë vlerësimin përkatës sipas kriterëve të parashtuara në “Rregulloren e posacme për detyrimet përmbyllëse në nivelin Bachelor”.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e programit te studimeve cikli i pare 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Email per udheheqjet e temave te diplomes.pdf</i></p> <p><i>Ngritje komision ad hoc vlersim prov diplomim.dep financ kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve Permyllyese Bachelor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas RVB për këtë kriter, Institucioni asiston studentin duke vendosur në dispozicion të tij burime materiale nga biblioteka dhe biblioteka online si edhe sallat me kompjutera dhe laboratorë sipas nevojave të studentëve. Konfirmuar me studentët edhe gjatë vizitës në Institucion. Studentët u shprehën se kishin akses në bibliotekën fizike dhe atë elektronike dhe mund të shfrytëzonin laboratorët e institucionit për të përgatitur punimin e mikrotezës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Vizita nw Institucion</i></p> <p><i>Liste E-books te disponueshme për përdorim.xlsx</i></p> <p><i>Rregullorja e Bibliotekes.pdf</i></p>




	<p><i>Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.pdf</i></p> <p><i>Të dhënat për bibliotekën.pdf</i></p> <p><i>Të dhëna për platformat on-line- Biblioteka.docx</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas rregullore së programit të studimit (neni 21 dhe 22), dhe Rregullores se posacme të detyrimeve përmblylëse (neni 2), në përfundim të programit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet ose nëpërmjet punimit të diplomës ose nëpërmjet provimit përfundimtar. Vlerësimi i tezave të diplomave dhe i provimit bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti i Financë Kontabilitetit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit të Biznesit. Mbrojtja para komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij kurse anëtarët e komisionit dhe të tjerë të pranishëm kanë të drejtë të bëjnë pyetje studentit në lidhje me tezën e diplomës. Vlerësimi përfundimtar i tezës llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. Të gjitha këto specifika të parashtruara në rregulloren e programit të studimit u konfirmuan edhe nga diskutimet me stafin e programit të studimit gjatë vizitës në institucion</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e programit te studimeve cikli i pare 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve Permblylëse Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit (neni 22 pika 6) specifikon se studenti i cili kalon me sukses tezën e diplomës pajiset me diplomën përkatëse në përputhje me Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e UAMD. Me dhënien e diplomës studenti fiton të drejtën e shënimit të titullit të saj. Në dokumentin e diplomës shënohet fusha e studimit të përfunduar dhe specialiteti përkatës.</p> <p>Sipas Rregullores së Fakultetit të Biznesit (neni 81), diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, shoqërohen me suplementin e diplomës. Çdo formë diplome dhe certifikatë, përpara se të lëshohet, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në QSHA. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe</p>

	<p>rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Forma dhe specifikat e suplementit të diplomës përcaktohen në rregulloren e UAMD, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e programit të studimeve cikli i parë 'Bachelor' pr.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konfirmoi se në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit parashikohet ruajtja e dokumentacionit të studentit në Sekretarinë Mësimore (neni 74). Gjatë vizitës GVJ pati mundësinë të verifikonte ruajtjen e të dhënave për studentët në dosjet e arkivës. Pasi kontrolloi me zgjedhje dosjet e disa studentëve, GVJ konfirmon rregullsinë dhe plotësinë e tyre dhe shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi pasi UAMD ka parashikuar procedura të qarta në lidhje me shlyerjen e detyrimeve përmbyllëse në programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet. Këto detyrime dhe procedurat që duhen ndjekur si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik dhe ai administrativ janë formalizuar në Rregulloret e brendshme institucionale.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT



**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar për periudhën 2020- 2022 është si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 34 pedagogë nga të cilët 17 PAE dhe 17 PAK (50 % /50 %);
2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 34 pedagogë nga të cilët 17 PAE dhe 17 PAK (50 % /50 %);
3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 28 pedagogë nga të cilët 16 PAE dhe 12 PAK (57 % / 43 %);

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	1	-	2	-	1	-
Prof.As.Dr	1	-	-	-	1	-
Dr/PhD	10	4	10	8	9	5
Msc	5	13	5	9	5	7
Në total	17	17	17	17	16	12

Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.

**Referenca:**

*Short Bio të stafit akademik dep FK , bachelor FK.docx*

*CV e stafit akademik të programit të studimit.pdf*

	<p><i>Përputhja e Formimit me angazhimin për personelin akademik F-K.pdf</i></p> <p><i>Fushat kërkimore të dep. FK për ciklin 1.2.3, 25.01.2022.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet, tab 6</i></p>																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike (sipas të dhënave të tabelës 12 në RVB) jepet në vijim dhe është në përputhje me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi sipas të cilit PAE duhet të realizojnë të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor.</p> <table border="1" data-bbox="584 600 1353 891"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>3375</td> <td>2970</td> <td>405</td> <td>88% / 12 %</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>4185</td> <td>3600</td> <td>585</td> <td>86% / 14 %</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>4320</td> <td>3330</td> <td>990</td> <td>77% / 23 %</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstaton një ngarkesë totale të personelit akademik mbi normën e parashikuar sipas nivelit të kualifikimit, por brenda parashikimeve të mbingarkesës së lejuar sipas kuadrit rregullator në fuqi që merr parasysh numrin maksimal të lëndëve që mund të mbulojë një pedagog dhe orët suplementare.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat Ngarkesa e departamentit 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2019-2020	3375	2970	405	88% / 12 %	2020-2021	4185	3600	585	86% / 14 %	2021-2022	4320	3330	990	77% / 23 %
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2019-2020	3375	2970	405	88% / 12 %																	
2020-2021	4185	3600	585	86% / 14 %																	
2021-2022	4320	3330	990	77% / 23 %																	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime</p>	<p>Referuar DVV, RVB dhe gjithashtu vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin Bachelor në Financë Kontabilitet dhe Departamentit Financë Kontabilitet. Punësimi i stafit është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Ndryshimi i konstatuar në stafin akademik efektiv rezulton më pak se 5%.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Model Kontrate Pune - UAMD.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>																				

shoqërore dhe shëndetësore.	<p><i>Raporti mujor i pagës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>RVB dhe dokumentacioni i DVV paraqet qartë procedure e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë përcakton kriteret të cilat përcillen dhe miratohen nga Drejtuesi i saj, më pas përcillen në Rektorat. Rregullorja për Rekrutimin e Stafit përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit <i>ad hoc</i> që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Njoftimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe gjithashtu në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf, Neni 103</i></p> <p><i>Kriteret e miratuara në department FK për rekrutimin e stafit të brëndshëm.pdf</i></p> <p><i>Relacion rekrutimi lektoresh me kohe te pjesshme 2020-2021 dhe 2021-2022 Dep FK.pdf</i></p> <p><i>Komisioni Ad Hoc per Rekrutime lektore PT_ 29.10.2020.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që Fakulteti i Biznesit ka staf ndihmës për departamentin duke përfshirë dhe asistënten e angazhuar në punët administrative. Gjithashtu pjesë e stafit ndihmës për realizimin e orëve laboratorike janë dhe dy laborantë të cilët asistojnë në ambientin e laboratorit, i cili përdoret nga stafi akademik i Departamentit të Financë Konatbilitetit gjithashtu.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i></p> <p><i>Organigrama e Universitetit Aleksandër Moisu.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion që UAMD, me përgjegjës Drejtorinë e Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Financë Kontabilitet. Dy dosje rastësore te personelit u verifikuan dhe GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar. Të dhënave të përditësuara të personelit u bashkangjiten dhe të dhënat e aktiviteti shkencorë dhe akademik referuar</p>

<p>mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>formularëve të vetvlerësimit të cilët vlerësohen dhe nga Drejtuesi i njësisë bazë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që UAMD në nivel institucioni por edhe Fakulteti i Biznesit dhe vetë Departamenti i Financë Kontabilitetit kanë marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione dhe organizata biznesi të cilat ndihmojnë dhe ofrojnë studentëve të programit Bachelor në Financë Kontabilitet praktika profesionale. Sektori i Karrierës dhe Alumnit i cili operon nën Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, ofron ndihmë dhe është në dispozicion të studentëve përgjatë praktikës profesionale dhe punësimit pas diplomimit të tyre. GVJ konfirmoi këtë process dhe nga takimi me studentët e programit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf, Neni 15</i></p> <p><i>Rregullore e detyrimeve Permbyllese Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Lista e marrëveshjeve në kuadër Institucional të UAMD.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritesë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e</p>	<p>Bazuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që praktika profesionale nuk është ende e aplikuar për vitet në shqyrtim duke qënë ndryshim i parashikuar për vitet e ardhshme. Ndërkohë janë krijuar rregulloret dhe formularët përkatës të vlerësimit të praktikave nga profesorët ndjekes dhe komisioni që do të ngrihet me këtë qëllim.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Lista e marrëveshjeve në kuadër Institucional të UAMD.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti.pdf</i></p> <p><i>Formulari vlerësimit të lektori udhëheqes.pdf</i></p>



vlerësimin të tyre për praktikën profesionale.	<i>Formulari I vlerësimin të komisionit.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet në përmbushje të plotë të këtij standarti bazuar në saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar dhe në RVB. Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit ka të angazhuar personel akademik dhe ndihmës për realizimin e programit. Departamenti ka në dispozicion një laborator, asistentë dhe softwarët e nevojshme për orët laboratorike. Bazuar në rregulloren e institucionit ka procedura të qarta mbi rekrutimin e stafit dhe dosjet e cdo personeli mbahen dhe përditësohen në përputhshmëri me rregullatorët në fuqi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve													
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>UAMD zhvillon procesin mësimorë në tre godina dhe Fakulteti i Biznesit zhvillon këtë process në Godinen e dytë në Spitalë. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatori që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimorë për programin Bachelor në Financë Kontabilitet janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Përkatësisht, në dispozicion janë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mjedisi - FB</th> <th>Nr. Sallash</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td>Salla &amp; Laboratorë informatike, për aktivitete, etj</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Zyra për stafin</td> <td>29</td> </tr> <tr> <td>Bibliotekë</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Ambiente ndihmëse: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Librari/fotokopje</li> <li>▪ Zyre informacioni</li> <li>▪ Mjedise sherbimi</li> </ul> </td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table>		Mjedisi - FB	Nr. Sallash	Salla leksioni	16	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	2	Zyra për stafin	29	Bibliotekë	1	Ambiente ndihmëse: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Librari/fotokopje</li> <li>▪ Zyre informacioni</li> <li>▪ Mjedise sherbimi</li> </ul>	4
Mjedisi - FB	Nr. Sallash													
Salla leksioni	16													
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	2													
Zyra për stafin	29													
Bibliotekë	1													
Ambiente ndihmëse: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Librari/fotokopje</li> <li>▪ Zyre informacioni</li> <li>▪ Mjedise sherbimi</li> </ul>	4													

	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i></p> <p><i>Raport Vjetor i veprimtarise mesimore kerkimore shkencore dhe financiare per v.a. UAMD 2021-2022 ...pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës që sallat që përdorën gjatë procesit mësimorë janë të pajisura dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizsshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik.</p> <p>Sallat e leksionit dhe laboratorit janë të pajisura me videoprojektorë (të montueshëm), tabela bashkëkohore, kompjutera dhe vende pune me internet. Laboratori në dispozicion të programit Bachelor në Financë Kontabilitet ofron 52 vende për studentët dhe disa softëare në dispozicion të lëndëve të ndryshme. Në mesin e përdorur nga Fakulteti i Biznesit ofrohet dhe salla e bibliotekës për studentët dhe të gjitha ambjentet dhe zyrat e stafit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për procesin mësimorë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i></p> <p><i>Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB...xlsx (e pa aksesueshme)</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që institucioni ka infrastrukturë të pajisur specifikisht për të përmbushur me sukses programin. Këto mjedise janë në dispozicion të studentëve dhe të përshtatshme sipas natyrës dhe nevojave të programit të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>



programit të studimit në tërësi.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në DVV, RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatori që Fakulteti i Biznesit, i cili ofron programin Bachelor në Financë Kontabilitet ofron për studentët dy laboratorë, ku i dyti është shtuar rishtazi si laborator i Doktoraturës. Laboratorët ofrojnë pajisjet e duhura teknologjike dhe programet standarte dhe specifike si Financa 5, SPSS, Evieës të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe të përshtatshme sipas natyrës dhe nevojave të programit të studimit.  <b>Referenca:</b> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat</i> <i>Vizita në Institucion</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur plotësisht pasi bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion është konstatuar që UAMD ka në dispozicion të Fakultetit të Biznesit Godinën 2 e cila mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të procesit mësimorë.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi IV.3

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi që pedagogët e lëndëve paraqesin cdo fillim semestri te studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundesohet nga vetë ato dhe biblioteka. Cdo fillim semestri stafi akademik bën përditësimin e literaturës në përdorim të cdo lënde në mënyrë që të garantohet marrja e njohurive të nevojshme por dhe sa më bashkëkohore. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Krahas literaturës

<p>parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>në gjuhën shqipe, në syllabus studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze) në funksion të thellimit të njohurive të fushës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Model Syllabusi v.a 2021-2022 Financat Personale.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konfirmoi në takim me stafin procesin e përditësimit të literaturës e cila inicohet nga kërkesat e tyre në njësine bazë, e cila ndjek procesin më pas.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që UAMD vë në dispozicion të studentëve dhe stafit të Fakultetit të Biznesit bibliotekën nr 2 (220 m<sup>2</sup>) e cila mundëson ambiente studimi dhe sociale të shfrytëzueshme për aktivitet kërkimorë dhe veprimtari promovuese. Studentët e UAMD kanë akses dhe në dy biblioteka online si JSTOR dhe EBSCO. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.pdf</i></p> <p><i>Të dhënat për bibliotekën.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive</p>	<p>Biblioteka disponon dhe një fond të mbyllur me literaturë të përditësuar si në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, fondi fizik i saj është i përbërë nga 600 tituj libra akademike, dhe gjithashtu është e pajisur me revista, gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivë akademike fizike dhe digjitale, të gjitha në dispozicion për mbulimin e procesit mësimorë. Studentët e UAMD kanë akses dhe në dy biblioteka online si JSTOR dhe EBSCO. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p><b>Referenca:</b></p>



<p>mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.pdf</i></p> <p><i>Të dhënat për bibliotekën.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit Bachelor në Financë Kontabilitet, që UAMD ofron për të gjithë dhe pa pagesë dy biblioteka online si JSTOR dhe EBSCO. Studentët konfirmuan dhe përdorimin e këtyre bibliotekave në periudha të përgatitjes së projekteve apo detyrave të ndryshme të kursit. Biblioteka ofron dhe sistemet KOHA dhe COBISS, të cilat ndihmojnë përdoruesit për shkarkimin e librave apo artikujve shkencorë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.pdf</i></p> <p><i>Të dhënat për bibliotekën.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në institucion, që biblioteka është e pajisur me teknologjinë e nevojshme për të lehtësuar veprimtaritë kërkuese dhe studimore. Biblioteka ofron dhe sistemet KOHA dhe COBISS, të cilat ndihmojnë përdoruesit për shkarkimin e librave apo artikujve shkencorë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Të dhënat për bibliotekën.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të</p>	<p>GVJ konstatoi që Biblioteka e Fakultetit të Biznesit operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve cdo ditë të javës, duke përfshirë dhe fundjavën, në mënyrë që shërbimi për studentët të jete jo vetëm në oraret e tyre sipas programeve të studimeve por edhe e pandërprerë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.pdf</i></p> <p><i>Rregullorja e Bibliotekës.pdf</i></p>

studentëve dhe kapacitetit të saj.	<i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që Departamenti i Financë Kontabilitetit, përgjegjës për programin e Bachelor në Financë Kontabilitet, në periudhë të vazhdueshme evidenton nevojat e fondit fizik dhe online të bibliotekës dhe ndjek procesin e përditësimit të këtij fondi.  <b>Referenca:</b> <i>Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.pdf</i> <i>Të dhënat për bibliotekën.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur plotësisht, kjo e konstatuar nga DVV dhe vizita me stafin dhe studentët e programit Bachelor në Financë Kontabilitet. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. Biblioteka ofron infrastrukturën e nevojshme për akomodim dhe shfrytëzim optimal në mënyrë të barabartë nga studentët dhe pedagogët e të gjithë programeve të studimit të UAMD.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në institucion që Sekretaria e Fakultetit të Biznesit dhe sekretaritet e programeve realizojnë sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët. Gjatë takimit në sekretarinet e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe dy dosje të zgjedhura të studentëve në programin Bachelor në Financë Kontabilitet, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi tjetër i menaxhimit të informacion në përdorim është platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB.pdf</i></p> <p><i>Përdorimi dhe plementimi i Sistemit Pitagora -RASH.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe partnëet e angazhuar në programin Bachelor në Financë Kontabilitet menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Burimeve Bjerëzore. Departamenti i Financë Kontabilitetit mbledh dhe perditëson informacionin akademik dhe shkencorë të stafit me anë të raporteve të vetvlerësimit dhe ja përcjell zyrës së Burimeve Njerëzore. Gjate vizitës u shqyrtuan dy dosje fizike të stafit, të cilat rezultuan me informacion të përditësuar.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e brëndshme e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike.doc</i></p> <p><i>CV e stafit akademik të programit të studimit.pdf</i></p> <p><i>Dosje të vetvlerësimit të stafit akademik dep FK , bachelor FK.pdf</i></p> <p><i>Raport Vjetor i veprimtarisë mesimore kërkimore shkencore dhe financiare per v.a. UAMD 2021-2022 ...pdf</i></p> <p><i>Raport Vetëvlerësimi Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë UAMD: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Përdorimi dhe plementimi i Sistemit Pitagora -RASH.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Platforma PITAGORA është sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e UAMD, por GVJ konstatoi si nga RVB dhe nga vizita në institucion që stafi përdor dhe platformat Google Classroom dhe Microsoft Teams si metoda interactive për komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe shpërndarjen e materialeve ndihmese dhe programit të lëndës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Metodat interaktive të përdorura për mesimdhëni.pdf</i></p> <p><i>Relacion për zhvillimin e mësimin online 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025 .pdf</i></p> <p><i>Përdorimi dhe plementimi i Sistemit Pitagora -RASH.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu _Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale të aktivitetit akademik nuk referohet vetëm në platformat e sipër përmendura por dhe në regjistrin e liste- prezencës, ku cdo staf akademik duhet të marrë dhe frimosë për orët mësimore të kryera. GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UAMD garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu _Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>



	<i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të UAMD publikohet në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu rrjetet sociale të Departmaentit paraqesin informacion të vazhdueshëm për të interesuarit. <b>Referenca:</b> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht, UAMD përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë universitetit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UAMD.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, gjithashtu në vizitën pranë institucionit GVJ konstaton Departmaneti i Financë Kontabilitetit ka një pjesë të vecantë në strukturën e buxhetit për UAMD, e cila përfshin zërat e kostove financiare dhe është në përputhje me struktura buxhetore të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar me udhëzim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomizë. Ky plan financiar i cili përlllogarit kostot e mbulimit të ciklit të plotë të studimit por edhe tarifatat dhe pagesat studentore, hartohet nga Drejtoria e Financës dhe Buxhëtit të UAMD. <b>Referenca:</b> <i>Ligji nr. 88-2019 per buxhetin e vitit 2020.pdf</i> <i>Ligji nr. 9936.2008 Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.doc</i>

	<p><i>Plani financiar i programit te studimit, .Pika 12. Tarifa shkollimit Bsc FK.pdf</i></p> <p><i>Vendimet për tarifaf dhe pagesat studentore.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV dhe vizitës në institucion se Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësi bazë për programin Bachelor në Financë Kontabilitet harton një plan financiar duke përfshirë të gjitha kostot për staf akademik efektivë dhe me kontratë, kosto për materiale, literaturë, aksesin në teknologji dhe shërbime të tjera që financojnë burimet njerëzore në aktivitete akademike, investime apo projekte. Pas Departamentit plani financiar kalon ne Fakultet dhe është objekt diskutimi dhe aprovimi nga senati dhe Bordi Administrimit të Institucionit, të cilëve u dorëzohet cdo vit një raport financiar për shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Plani financiar i programit te studimit, .Pika 12. Tarifa shkollimit Bsc FK.pdf</i></p> <p><i>Raporti financiar per shpenzime dhe te ardhura te realizuara per v.a. 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Auditimi i brendshëm kryhet në mënyrë të pavarur në UAMD në përputhje me Ligjin nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm. Bordi i Administrimit miraton kartën e Auditit të UAMD ku përfshihen qellimi, misioni, objektivat, përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë dhe organizimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm në UAMD. Raportime periodike dorëzohen nga auditimi i brendshëm në njësinë bazë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Raporti i auditit të brendshëm për vitet 2019-2022.pdf</i></p> <p><i>Auditi_Pyetesori i vetevleresimit te AB (Aneksi nr.3).pdf</i></p> <p><i>Auditi, Struktura Raportimit Vjetor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse</p>	<p>Bazuar në informacionin e DVV, UAMD paraqet cdo vit akademik analizën vjetore për të gjithë veprimtaritë e kryera, pasqyrën financiare të lidhur me gjendjen, angazhimin e</p>



<p>për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>personelit, tarifat etj. Ky raport prezantohet dhe është çështje diskutimi mes anëtarëve të ftuar nga Rektorati, Administratori, Bordi Administrimit, Senati, personel akademik dhe administrative dhe përfaqësues të studenteve. Raporti publikohet gjithashtu në faqen e internetit të UAMD.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Email për mbledhje të përbashkët SA dhe BA për miratimin e raportit vjetor.jpeg</i></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/vendime/">https://uamd.edu.al/vendime/</a></i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UAMD është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UAMD janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Fondet e buxhetit të shtetit në përputhje me udhëzimet e MFE shpërndahen në formë granti për politikat e zhvillimit të UAMD, për mësimdhënien dhe për punën kërkimore-shkencore e veprimtaritë krijuese. Përdorimi i fondeve publike nga UAMD bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, GVJ konstatoi se për periudhën 2020-2021 ecuria e të ardhurave të realizuara paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Viti 2020 rreth 79% fonde të grantit qendror dhe 21% fonde nga tarifatat për dhe gjatë shkollimit;</li> <li>▪ Viti 2021 rreth 76% fonde të grantit qendror dhe 24% fonde nga tarifatat për dhe gjatë shkollimit;</li> <li>▪ Viti 2022 – informacioni në mungesë.</li> </ul> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Miratimi i Buxhetit Vjetor 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Plan Buxheti 2023-2025.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht, pasi u konstatua se UAMD harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe njesie bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe raportet përcillen</i></p>



	<i>deri në njësinë bazë. UAMD si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UAMD, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e UAMD dhe FB specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Procesi i regjistrimit të studentëve ndiqet nga grupet e punës, të ngritura me vendim të Rektorit dhe dijëni të Bordit të Administrimit, për qëllim monitorimin e këtij procesi.  <b>Referenca:</b> <i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i> <i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UAMD, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konstaton se barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantoohen edhe nga kërkesat (nenet) specifike të statutit



<p>studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>(nenet 62 &amp; 89) dhe rregullores së UAMD (neni 115), dhe të rregullores së FB (neni 84).</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i>  <i>Ngritje komisionet per pranime studente BSC vitit i pare.pdf</i>  <b>KUOTA, TE DHENAT E APLIKANTEVE PER TRANSFERIM STUDIMESH.pdf</b>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe RVB, dhe pas vizitës në institucion, konstatoi që UAMD harton dhe bën publike kriteret dhe kuotat e pranimit për çdo cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.</p> <p>Në UAMD, Departamentet propozojnë kriteret e pranimit për çdo program studimi që mbulojnë si dhe kriteret që do përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteret e propozuara nga Njësia Bazë miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatin Akademik, u vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime. Këto kriteret parashikojnë dhe përfshijnë edhe kandidatë që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj. Pranimet e studentëve në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të veçantë të komisioneve ad-hoc, në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturorë, të cilat verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, të ngritura nga njësia kryesore.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i>  <i>Per Publikimin E Krieteve Te Pranimi Te Studenteve Per Vitin Akademik 2022-2023.Pdf</i>  <i>Memo-Kuota Pranimi Student 3 Nivele Dep.Fin.Kontabilitet 2021-2022.Pdf</i>  <i>Kuotat e pranimit uamd 2022-2023.pdf</i>  <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UAMD se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të</p>

<p>studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>interesuariat. Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen zyrtare të univesitetit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Mbi Kriteret E Pranimit Te Sistemit Bachelor Per Dep. Finance Konatbilitet Per Vitin Akademik 2023-2024.Pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin dhe studentët konstatoi që si përpara fillimit të vitit akademik por edhe gjatë tij, UAMD organizon takime dhe aktivitete me nxënësit e interesuar duke i informuar mbi kërkesat e përgjithshme por edhe të veçanta për cdo program studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Per Publikimin E Krieteve Te Pranimit Te Studenteve Per Vitin Akademik 2022-2023.Pdf</i></p> <p><i>Mbi Kriteret E Pranimit Te Sistemit Bachelor Per Dep. Finance Konatbilitet Per Vitin Akademik 2023-2024.Pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka të hartuara dhe pjesë të rregulloreve të veçanta kritere dhe kuota për kandidatë me aftësi të veçanta, kandidatë nga trojet dhe shtresave të marginalizuara. Bazuar në rregullore nën varësi të Dekanatit të Studentëve pranë Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës do të ngrihet Njësia e Shërbimit të Aftësisë së Kufizuar, e cila asiston çdo student me nevoja specifike.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Kuotat e pranimit uamd 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Studentët me Aftësi të kufizuar.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ konstatoi se në kuadrin rregullator të UAMD parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve të huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS, pa vendosur kritere të tjera specifike.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Kuotat e pranimit uamd 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të</p>	<p>UAMD duke ndjekur dhe kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitim financiar për studentët e</p>

ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar. <b>Referenca:</b> <i>Njoftimi per aplikimin per burse.pdf</i> <i>Formular per perjashtim nga tarifa 2022-2023. Bachelor.doc</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se standarti përbushet plotësisht, duke konstatuar se në kuadrin rregullator të UAMD parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet bachelor, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. UAMD ka një rregullore të vecantë për kandidatët me aftësi të veçanta, pakicave, shtresave në nevojë dhe kandidatëve nga shtete të tjera. UAMD respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me politikën e ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për studentët cilësorë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UAMD, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin por UAMD aplikon gjithashtu dhe sistemin e automatizuar të Pitagorës, i cili jep akses studentëve të informohen në kohë reale për vlerësimet e tyre, programet e lëndëve dhe gjithë ciklit të studimeve.  <b>Referenca:</b>

	<p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Urdher Ngritje Grupi Pune Per Pitagora Dhe Moodle 23.10.2020.Pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD përmes sekretarive të programeve të ciklit të parë dhe bazuar në rregullore të FB informon dhe orjenton studentët në lidhje mundësinë për njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, në një program studimi të Fakultetit, merret nga komisioni ad-hoc përkatës, i ngritur nga njësia bazë pranuese.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Informim-ne-rrjete-sociale-FB.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara në platformen Pitagora dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimin, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. Studentët informuan GVJ se në cdo javë të parë të semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për cdo lëndë duke u njohur me syllabusin e lëndës.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu _Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe</p>	<p>Në takimin me studentët e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet, GVJ konstatoi se studentët ishin të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi.</p>




<p>diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti duhet të ketë notë kaluese në të gjitha lëndët e detyrueshme që përmban kurrikula dhe duhet të ketë notë kaluese në të paktën një lëndë me zgjedhje nga grupi i lëndëve me zgjedhje të përcaktuara në kurrikulën e programit të studimit. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar dhe pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Evidenca 36 (mungese)</i></p> <p><i>Email per udheheqjet e temave te diplomes.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare të UAMD, GVJ konstatoi se çdo fillim viti akademik, Departament i Financë-Kontabilitetit në bashkëpunim me strukturat e tjera brenda institucionit zhvillon aktivitete informuese mbi programet e studimit. Gjatë takimit me stafin GVJ konfirmoi se anëtarë të departamentit përzgjidhen cdo vit për të informuar në lidhje me çdo program studimi për publikun e gjerë dhe maturantët në vecanti.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Grupet e punes per njohjen e maturanteve me programet e studimit UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se UAMD vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre përmes platformës së Pitagorës, si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Gjithashtu studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet informohen nga pedagogët përkatës, sekretaritet dhe faqja zyrtare web e UAMD për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Te dhena per Fakultetin e Biznesit.pptx</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të cilat u jepën studentëve në ditët e para në auditor dhe në faqen zyrtare apo rrjetet sociale të institucionit. Përmes platformës në përdorim dhe takimeve të organizuara studentët mund të konsultojnë syllabuset dhe informacione të përditësuara mbi veprimtaritë mësimore.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Njoftime studenteve te vitit te pare.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Biznesit dhe zyra e Alumnit dhe Karrierës kanë dhe lidhin marrëveshje në vazhdimësi me institucione dhe biznese për të mbështetur studentet e tyre gjatë praktikave dhe mbi të gjitha për tju ofruar mundësi punësimi. Gjatë takimit me përfaqësues së zyrës së Alumnit dhe Karrierës, GVJ u njoh me disa aktivitete që organizohen në kuadër të orientimit të studentëve drejt dhe në tregun e punës, ku më i rëndësishmi është Panairi i Punës, i cili tashmë është një traditë për UAMD.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Panairi i Punes.pdf</i></p> <p><i>Aktivitete Fakulteti Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion</p>	<p>GVJ konstatoi se Sekretaritet Mësimore, Sektori i Karrierës dhe Alumnit, si dhe pedagogët e Departamentit të Financë</p>



<p>informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Kontabilitetit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Njoftime studenteve te vitit te pare.pdf</i></p> <p><i>Informim-dhe-orientim-per-dita-e-pare-ne-rrjete-sociale.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ konstatoi nëpërmjet faqes web zyrtare të UAMD dhe hapësirës së dedikuar në platformën PITAGORA, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet dhe aktivitete të tjera të UAMD. Gjithashtu studentët, sipas programit të studimit, mund të konsultojnë orarin mësimor, grafikun dhe rezultatet e provimeve si edhe materialet e postuara nga pedagogët në faqet tyre individuale të integruara në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/pitagora/">https://uamd.edu.al/pitagora/</a></i></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/orari/">https://uamd.edu.al/orari/</a></i></p> <p><i>Përdorimi dhe plementimi i Sistemit Pitagora -RASH.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht pasi konstatoi se në UAMD studentët e programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet informohen nga pedagogët përkatës, sekretaritet dhe faqja zyrtare web e UAMD për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. FB dhe Sektori i Karrierës dhe Alumnit kanë dhe rrisin numrin e marrëveshjeve, gjithashtu kujdesen për informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.4**



**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Konkretisht, Drejtoria Administrimit dhe Shërbimeve Akademike në varësi të Rektorit është struktura që në bashkëpunim edhe me Departamentet përgjegjëse, administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Komunikim me Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>																
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="592 1397 1366 1671"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Transferime</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>107 studentë</td> <td>3 studentë</td> <td>69 studentë</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>113 studentë</td> <td>2 studentë</td> <td>74 studentë</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>115 studentë</td> <td></td> <td>në proces</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe 5 largime (çregjistrime). Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p>	Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Të diplomuar	2020-2021	107 studentë	3 studentë	69 studentë	2021-2022	113 studentë	2 studentë	74 studentë	2022-2023	115 studentë		në proces
Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Të diplomuar														
2020-2021	107 studentë	3 studentë	69 studentë														
2021-2022	113 studentë	2 studentë	74 studentë														
2022-2023	115 studentë		në proces														





	<p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese Bachelor Finance Kontabilitet.pdf (Tabelat 21, 22)</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UAMD (neni 81-83, 89 Rregullore e Universitetit dhe neni 74 pika 7 Rregullore e Fakultetit të Biznesit). Sektori i Sekretarisë Mësimore kujdeset drejtpërdrejt për ruajtjen e informacionit në formatin letër (regjistrat e sekretarisë mësimore, procesverbalet e provimeve &amp; dosjet personale të studentëve) dhe në versionin elektronik (në sistemin e brendshëm informatik PITAGORA). Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si edhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sekretarisa Mësimore e UAMD është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ, në nivel njësie kryesore e cila zhvillon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Biznesit analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare), si dhe kalueshmërinë sipas lëndëve dhe programeve të studimit. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së njësive bazë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB.pdf</i></p>

	<i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Biznesit analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare), si dhe kalueshmërinë sipas lëndëve dhe programeve të studimit. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së njësisë bazë. Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit bashkëpunon me Sektorin e Karrierës dhe Alumni për vlerësimin e të diplomuarve dhe performancës së sistemit universitar, si dhe lehtësimit të procesit të rekrutimit nga punëdhënësit.  <b>Referenca:</b> <i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i> <i>Analiza ecurise dhe studimi i tregut te punes p.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatori se UAMD mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm i informacionit i UAMD mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Departamenti i Financë Kontabilitetit në bashkëpunim me Sektorin e Karrierës dhe Alumni analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundësuar ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti e në nivel

<p>vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Universiteti, si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të UAMD, në Komisionet e Përherëshme dhe në Bordin e Administrimit të UAMD.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Zgjedhjen e studenteve per antar Bordi.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se në statutin e UAMD dhe rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur me mandat 2-vjeçar në një proces transparent.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu _Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu _Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se aktualisht UAMD përdor në fund të çdo semestri pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor, stafin akademik, si dhe infrastrukturën e institucionit. Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. Rezultatet e pyetësorëve janë objekt diskutimi në të gjitha strukturat e UAMD dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerren duke filluar që nga departamenti.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Pyetesor _Studentët për Diplomim BACHELOR.pdf</i></p> <p><i>Pyetesor mbi rrjetin Alumni dhe Panairin e Punës _Karrierës.pdf</i></p> <p><i>Pyetesor shperndare eksperteve per permiresimin e kurrikulave _BSC.docx</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UAMD, GVJ konstatoi se në cdo fund semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve me anë të pyetësorëve të cilët mund ti plotësojnë për cdo lëndë dhe pedagog.</p>

<p>dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Ndërkohë në periudhën e caktuar të sezonit të provimeve, studentët njoftohen nga pedagogët për rezultat e tyre në platformën në përdorim Pitagora, duke u dhënë dhe informacion mbi kohën në dispozicion për ballafaqimin me pedagogun e lëndës, ku studentët mund të diskutojnë mbi rezultatit e tyre dhe të reflektojnë gabimet e tyre. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren të Fakultetit të Biznesit, neni 62, studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimit. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi se UAMD ka mundur angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Bordin e Administrimit si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Institucioni përdor edhe pyetësorin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Kuadri rregullator i UAMD, parashikon të drejtën e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe vlerësimit në provim.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të

GVJ konstatoi se rregullorja e Fakultetit të Biznesit parashikohen qartë procedurat dhe strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretarite Mësimore që janë në



<p>studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>funksiione administrative nën njësinë kryesore dhe Sektori i Karrierës dhe Alumnit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi struktura si Sekretaria Mësimore në bashkëpunim me njësitë bazë të UAMD dhe ndihmuar nga platforma Pitagora në përdorim ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtëpërdrejtë me procesin mësimor. Sekretaritet dhe Sektori i Karrierës garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në lidhje me ndjekjen dhe këshillimin e studentëve gjatë procesit mësimorë, të dedikohen dhe këshillues akademik, të cilët do të ndihmonin në përzgjedhjen e lëndëve me zgjedhje por edhe ndjekjen e karrierës më të përshtatshme për studentet, ku ndërkohë do ishin dhe një orientues për çdo problematikë tjetër të hasur.</i></p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Përdorimi dhe plementimi i Sistemit Pitagora -RASH.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe</p>	<p>Bazuar në informacionin në RVB, organigramën dhe rregulloreve të UAMD, rezultoi se shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit dhe zyra e Karrierës pranë Fakultetit të Biznesit. Në takimin me përfaqësuesin e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e kësaj strukture në bashkëpunim edhe me strukturat/zyrat e tjera të UAMD fokusohet në informim të vazhdueshëm të studentëve në lidhje me bashkëpunimet me biznesin, organizojnë trainime dhe orientime në lidhje me praktikat profesionale, gjithashtu në gjurmimin e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve (mbështetja e Alumni FB). Ky Sektor në kuadër të orientimit dhe rritjes së kontakteve të studentëve me tregun e punës, organizon çdo vit Panairin e Punës. Struktura e Karrierës dhe Alumnit zhvillon aktivitetin e saj bazuar në planin vjetor të</p>

<p>orientimin në tregun e punës.</p>	<p>punës të miratuar ku parashikohen aktivitetet e nevojshme, si dhe harton një raport vjetor mbi performancën e saj.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Raporti Alumni Network.pdf</i></p> <p><i>Komunikim per praktika pune per studentet.pdf</i></p> <p><i>Aktivitete Fakulteti Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se sektori i Karrierës dhe Alumnit përmes një pyetsori realizon gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe harton një raport me rezultatet e punësimit të studentëve të UAMD. Këto raporte u vihen në dispozicion të gjitha strukturave të UAMD, që nga njësia bazë, si dhe bëhen pjesë e analizave vjetore të tyre. Aktivitetet e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit si Panairi i Punës kanë hapësirën e tyre si ne faqen zyrtare të UAMD dhe në rrjetet sociale, ku publikohen aktivitetet dhe udhëzues për studentët. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se numri i të diplomuarëve në Finance Kontabilitet, të cilët janë të punësuar në profesionin e tyre është më i lartë se ai i arritur nga gjurmimi i zyrave përkatëse.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Analiza ecurise dhe studimi i tregut te punes p.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht pasi konstatoi se Sekretariteti Mësimorë dhe Sektori i Karrierës dhe Alumnit të UAMD janë strukturuara në dispozicion të informimit &amp; shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit. Sektori i Karrierës dhe Alumnit dhe Alumni FB përmes pyetësorit online, realizon gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe hartojnë një raport me rezultatet e punësimit të studentëve të UAMD.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR


### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion dhe takimet e organizuara GVJ konstatoi se institucioni angazhohet për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Pedagoget janë shpesh pjesë e trainimeve dhe takimeve orientuese mbi metodat inovative, dhe aktualisht sin ë vazhdimësi të aplikimit gjatë pandemisë, stafi dhe studentët konfirmuan përdorimin e platformave Google Classroom dhe Teams. Platforma të përdorura për mësimdhënie gjatë pandemisë, dhe të përdorura më pas për kontakt direct me studentin duke krijuar hapësirë të cdo lëndë pëe shpërndaje te leksioneve, materialeve apo detyrave. Sikurse është përmëndur dhe më lart, një tjetër platformë e implementuar në UAMD është dhe Pitagora. Plani Strategjik 2020 - 2025 i UAMD i kushton vëmendje ndërmarrjes së hapave për një mësimdhënie interaktive me studentin në qendër, të bazuar edhe në eksperiencën e punës me projekte. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, synon të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu , Durrës.pdf</i></p> <p><i>Përdorimi dhe plementimi i Sistemit Pitagora -RASH.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Statuti i UAMD parashikon ngritjen e Njësie të Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel Fakulteti me qëllim koordinimin e veprimtarisë së sigurimit të cilësisë sipas</p>



<p>periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>programeve të studimit, gjithashtu GVJ konstatoi se referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë (neni 6), UAMD praktikon disa mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive të mësimdhënies të personelit akademik:</p> <p>Pyetësi i studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë në Rektorat.</p> <p>Vlerësimi i përgjegjësive të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJSBC (rregullore neni 6), në nivel institucioni. Gjithashtu, Rregullorja e UAMD, Rregullorja e FB dhe Rregullorja e Programit të Studimit parashikojnë të drejtën e ankimit për të gjithë studentët lidhur me procesin mësimor dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt një kërkesë me shkrim që i drejtohet Dekanit të Fakultetit sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vlerësimi i lektoreve _Raportet e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>





<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra NJSBC referuar dhe rregullores se saj, raporton mbi vlerësimet e mbledhura së pari tek personeli akademik e deri ne Rektorat. Këto raporte janë pjesë e dikutimeve brënda departamentit duke reflektuar gjithnjë drejt përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Vleresimi i lektoreve_Raportet e Fakultetit te Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe DVV, gjithashtu dhe nga vizita me stafin dhe përfaqësues së NJSBC, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve të personelit duke u bërë pjesë e mbledhjeve në department, ka si qellim dhe diskutimet konstruktive, të cilat promovojnë praktikat e mira dhe nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm. Gjithashtu, në takimin e zhvilluar me personelin akademik të këtij programi studimi, gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Vleresimi i lektoreve_Raportet e Fakultetit te Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Institucioni.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.2**



**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucionin GVJ konstatoi se, në planin strategjik të UAMD, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, bazuar në analizën SWOT të realizuar në ndihmë të planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu , Durrës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucionin GVJ konstatoi se, parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të Universitetit dhe duke ndjekur kuadrin ligjorë NJSBC është njëësia e cila ngrihet me Urdhër të Rektorit dhe ka shtatë anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një student.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në vizitën në institucionin GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UAMD realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Konkretisht, UAMD ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në vitin 2016, me një akreditim për 4 vite akademike, dhe është riakredituar në vitin 2021. Me vendimin Nr.18 të Bordit të Akreditimit, datë 24.03.2022 UAMD ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 4 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 23.03.2026. Ndërsa për programin e studimit Bachelor në Financë Kontabilitet ky është akreditim që kryhet për herë të parë.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

<p>përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p><i>Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit Institucional të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës -2016.pdf</i></p> <p><i>Çertifikate e Akreditimit Institucional.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UAMD paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës nga DKSC në Rektorat. Gjithashtu bazuar në dokumentacionin e DVV, u konstatua se vlerësimi i përgjegjësive të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, bëhet duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore. Gjatë takimit me përfaqësues të NJSBC të UAMD u konstatua se pjesë e mekanizmit të kontrollit të cilësisë në mësimdhënie janë dhe praktikave të vizitave të stafit gjatë orëve të leksioneve, ku vizitat përzgjidhen në mënyrë rastësore. Vetëvlerësimi i stafit akademik është një raport tjetër i cili referohet një formulari që plotësohet nga vetë stafi për arritjet dhe punën e tyre gjatë një viti akademik në mësimdhënie dhe në kuadër të kërimit shkencorë.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstatoi se në UAMD procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ndërkohë, UAMD ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 4 vite akademike dhe programi i studimit Bachelor në Financë Kontabilitet akreditohet për herë të parë.</p> <p>Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, raportet e vetvlerësimit të personelit akademik, si dhe analizat</p>

	<i>e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV se instrumenti që ofron të dhëna të rëndësishme mbi një sërë treguesish të performancës është rishikimi vjetor i veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore përgatitur nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë dhe miratuar nga NJSBC i cili përfshin, por nuk kufizohet në numrin e studentëve që diplomohen, numrin e publikimeve dhe kërkimeve shkencore, mënyrën sesi funksionon sistemi i sigurimit të cilësisë, si dhe çdo ankesë për funksionimin e sistemit. Ky është një instrument i dobishëm për NjBSC-në, KPGSC-në dhe Senatin Akademik për shqyrtimin e fushave problematike dhe marrjen e vendimeve rreth alokimit të burimeve dhe zhvillimeve të ardhshme.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, DVV dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoi Departamenti i Financë Kontabilitetit organizon mbledhje në vazhdimësi por dhe në fund të çdo semestri mësimor ku analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të</p>



<p>mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>UAMD sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Raporti i analizës përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, stafin akademik dhe studentët, menaxhimin e brendshëm dhe veprimtaritë ndihmëse.</p> <p>Ndërkohë në nivel institucioni DKSC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësore dhe sasore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët dhe stafi. Procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave realizohet nga DKSC e cila ja paraqet rezultatet e tyre Rektorit, Administratorit, KPGSC dhe Senatit Akademik për analiza të mëtejshme. Problematikat e evidentuara për secilin prej këtyre aspekteve shoqërohen me rekomandime dhe plan masash për trajtimin e mangësive dhe përmirësim të mëtejshëm.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu _Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Raport Vetëvlerësimi Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni I DVV dhe nga takimet me drejtuesin e Fakultetit dhe Departamentit Financë Kontabilitet dhe personeli akademik, se në UAMD ka procedura formale që përdoren për mbikqyrje periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përditësimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve çdo fillim viti akademik;</li> <li>- në fund të çdo semestri, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies;</li> <li>- dosja e vetëvlerësimit bazuar në kërkim shkencorë dhe angazhime akademike</li> <li>- monitorime të procesit mësimor &amp; analiza në mbledhjet e departamentit;</li> </ul> <p><i>GVJ rekomandon krijimin e një procedure e cila do të fokusohet tek vlerësimi i provimeve dhe detyrave të studentëve duke përfshirë të gjithë procesin e organizimit, formulimit dhe kontrollimit.</i></p> <p><b>Referenca:</b></p>

<p>shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor.pdf</i></p> <p><i>Raport Vetëvlerësimi Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Dosje të vetvlerësimit të stafit akademik dep FK , bachelor FK.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i DVV dhe RVB se në rregulloret e institucionit apo rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë janë të përfshira metoda të tërthorta të vlerësimit të procesit mësimorë dhe shërbejnë në përmirësimin e tij. GVJ vlerëson angazhimin e UAMD në realizimin e anketimeve online me studentët e diplomuar, e intervistave gjatë aktiviteteve si panairi i karrierës, si dhe hartimin e raporteve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe cilësinë e programeve të studimit që ofron.</p> <p><i>GVJ rekomandon realizimin e intervistave dhe pyetësorëve më të detajuar të të diplomuarve, duke përmirësuar numrin e përgjigjeve, gjithashtu dhe dokumentimin formal të komunikimit me bashkëpunëtorët e jashtëm. Rezultatet e tyre do sillnin rekomandime formale dhe të vjera për përditësimin e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstatoit se kuadri rregullator i UAMD parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni DKSC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësorë dhe sasore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët dhe stafi, dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit në DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Komunikim Pjesëmarrje e studenteve ne vendimet e Senatit Akademik.pdf</i></p> <p><i>Urdher 522 date 1.12.2022 per nje ndryshim ne urdhrin nr. 499 DATE 21.11.2022_Zgjedhje anetari student per Senatn Akademik.pdf</i></p> <p><i>Për ngritjen e grupeve të punës për akreditimin e programeve te studimit.pdf</i></p> <p><i>Zgjedhjen e studenteve per antar Bordi.pdf</i></p> <p><i>Diskutim ne Mbledhje Departamenti_PCV.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu, paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në UAMD, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të UAMD.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>

	<p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Për ngritjen e grupeve të punës për akreditimin e programeve të studimit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit në DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi pranë FB është ngritur Njësia e Sigurimi të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik dhe një student është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se UAMD garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UAMD angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UAMD dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p>





	<p><i>Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Pyetesor shperndare eksperteve per permiresimi.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UAMD përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Përmes aktiviteteve si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, UAMD realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, DVV dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UAMD parashikon publikimin e politikave, strategjive dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. UAMD përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><a href="https://uamd.edu.al/transparenca/">https://uamd.edu.al/transparenca/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Publikimet në faqen zyrtare web të UAMD dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes publikimeve në faqen zyrtare ëeb të UAMD dhe komunikimeve në platformën Pitagora.</p>

	<p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se pas vlerësimit të personelit akademik, raportet përcillen nga NJSBC në njësinë bazë të programit dhe FB. Raportët pasi u bëhen me dije personelit, diskutohen duke ndarë praktikat e mira dhe duke marrë masa për përmirësim të vazhdueshëm mbi problematikat e evidentuara.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Vlerësimi i lektoreve_Raportet e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UAMD realizohen periodikisht analiza në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme. Referuar Planit Strategjik të UAMD, vlerësohet efektiviteti dhe impakti i veprimtarive në kuadër të clerësimit të cilësisë dhe përmirësimin në vijim.</p> <p><b>Referenca:</b></p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Analiza ecurise dhe studimi i tregut te punes p.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore e Fakultetit të Biznesit_2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu , Durrës.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi aktivitet e organizuar në nivel fakulteti dhe departamenti në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtjshme. Aktivitetet si Panairi i Punës, Forumet e Hapura, nisma mbi transparencën të publikuara dhe në faqen zyrtare të UAMD kanë objektiv kryesorë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë të personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës.</p> <p><b>Referenca:</b></p>

cilësisë së programit të studimit.	<i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i> <i>Aktivitetet e Departamentit Finance Kontabilitetit 2020-2022.pdf</i> <a href="https://uamd.edu.al/transparenca/">https://uamd.edu.al/transparenca/</a> <i>Panairi i Punes.pdf</i> <i>Workshop organizuar për Stafin Akademik nga Fakulteti Biznesit.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht pasi konstatoi se UAMD publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti përfshihen dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktivitete të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Financë Kontabilitet**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Institucioni gëzon emër të mirë dhe ka përvoja të mëparshme të sukseshme në programe studimi cilësore në fushën ekonomike, të cilat ofrojnë një suport të mirë për ofrimin e programit aktual të studimit;
2. Programi i studimit ofrohet në një fushë e cila perceptohet si një nevojë përherë e madhe për t'u plotësuar dhe mbyshur me specialistë përkatës;
3. Një larmi e konsiderueshme e marrëveshjeve të bashkëpunimi me partnerë vendas dhe sidomos të huaj;
4. Angazhim në gjithnjë e më shumë projekte kërkimore të financuara brenda dhe jashtë vendit;



5. Angazhim dhe qëndrueshmëri të stafit akademik të kualifikuar, me eksperiencë dhe veprimtari kërkimore shkencore;
6. Politika nxitëse financiare për personelin akademik në mbështetje të publikimeve të artikujve shkencorë;
7. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si klasa, laboratorë, të pajisura me kompjutera, projektor, lidhje interneti të përshtatshme për nevojat e zhvillimit të orëve mësimore të programit të studimit Bachelor në Financë Kontabilitet;
8. Sistem efektiv i sigurimit të cilësisë, me struktura dhe përgjegjësi të qarta, që shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë;

**b. Pika të dobta:**

1. GVJ konstaton se pavarësisht se numri, emërtimi dhe gama e lëndëve të ofruara në programin e studimit synon të ofrojë njohuri të thelluara që mundësojnë formimin e shprehive dhe zotësive tek studentët, sasia e krediteve të parashikuara dhe orët në auditor për lëndët karakterizuese paraqitet e pamjaftueshme. Ngarkesa duket se është e shpërndarë në shumë lëndë të detyrueshme dhe njëkohësisht e pamjaftueshme në secilën prej tyre; (*standardet II,1,2, II,4,2; II,4,7*)

**Rekomandime:**

1. Për lëndët e rëndësishme në funksion të arritjes së objektivave (si kontabiliteti dhe financa), pra konkretisht lëndët karakterizuese (kategoria B) duhet të parashikohen më shumë kredite (të paktën 6);
2. Brenda limiteve që lejojnë ligjet në fuqi të bëhet një thjeshtim dhe lehtësim i përmbajtjes së programit të studimit përse i përket numrit të lëndëve, ose duke i kaluar si lëndë me zgjedhje në të njëjtin program studimi, ose duke i kaluar në programe studimi të nivelit të dytë;

**Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in Finance and Accounting**

**a. Strengths and Affirmations:**

1. The institution, with a strong reputation and a history of successful experiences in quality study programs within the economic field, offers valuable support to the current study program;
2. The field of study program being offered is recognized as a significant need that requires the expertise of relevant specialists;
3. The institution has established a significant number of collaboration agreements, with domestic and particularly with international partners;
4. Active involvement in an increasing number of funded research projects, both domestically and internationally;





5. The commitment and stability of a qualified academic staff, characterized by experience and active engagement in scientific research activities;
6. Implementation of a financial incentive policy for academic staff to encourage the publication of scientific articles;
7. The institution provides adequate and suitable environments for the execution of educational activities, including classrooms and laboratories equipped with computers, projectors, and internet connections tailored to the requirements of the Bachelor in Finance and Accounting study program;
8. The institution has an effective quality assurance system with clear structures and responsibilities aimed at fostering continuous improvement in quality;

**b. Weaknesses:**

1. External evaluation group notes that, despite the quantity, name, and scope of subjects offered in the study program aimed at providing profound knowledge for the development skills in students, the allocated credits and auditorium hours for characteristic subjects appear inadequate. The workload appears to be distributed across numerous compulsory subjects, resulting in insufficient coverage for each; (*Standards II,1,2; II,4,2; II,4,6; II,4,7*)

**Recommendations**

1. To meet the objectives, particularly for characteristic courses (category B), it is recommended to allocate a minimum of 6 credits for important subjects, such as accounting and finance;
2. Simplification of the content of Curricula the Study Program in terms of the number of the modules and subjects included, always abiding to the limits set by the legislation in force. This is suggested to be done either by including some of the subjects as elective or by redesigning them as subjects for other study programs of the second level;



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>			X	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

